USHTRIA

Viti i 68-të i botimit Nr. 39 (8240) | Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes | E premte, 3 tetor 2014

QENDRA E ASGJESIMIT TË MUNICIONEVE DHE EKSPLOZIVËVE

Certifikohen instruktorët e EOD-së niveli i parë nga ekipi i gardës së New Jersey-t

Në ambientet e AMMCO u zhvillua ceremonia e certifikimit të Instruktorëve të EOD-së niveli i I-rë

faqe 6

BASHKËPUNIMI

Atasheu ushtarak i Kosovës, n/kolonel Enver Dugolli, vizitë në Brigadën Logjistike

faqe 4

CEREMONIA

Ndjehemi krenarë që punuam së bashku

faqe 6

GJENERALMAJOR BAZO, VIZITË ZYRTARE NË GREQI

Shqipëri-Greqi, bashkëpunim i frytshëm ushtarak

faqe 5

AKTIVITETI

Shtabi i Përgjithshëm i FA shtron drekë për familjarët e ushtarakëve

Gjeneralmajor Jeronim Bazo: "Sot është koha që edhe ne t'ju shërbejmë juve po me të njëjtin përkushtim siç ju i keni shërbyer atdheut"

Faqe 4

Intervista e ministres së Mbrojtjes në Klan Kosova, përballë gazetarit Baton Haxhiu

Mbrojtja nuk është vetëm dhunë, është inteligjencë, strategji, politikë, diplomaci

Mimi Kodheli: Ministria e Mbrojtjes është pjesë e luftës kundër terrorit, pjesë e sigurisë dhe integritetit territorial të vendit dhe e sigurisë së qytetarëve të vet

Faqe 2-3

JENS STOLTENBERG MERR DETYRËN SI SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I NATO-S

Rasmussen i thotë lamtumirë Këshillit të Atlantikut të Veriut dhe stafit të NATO-s

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, i cili u largua zyrtarisht si Sekretari i Përgjithshëm i 12 i Aleancës, në fund të muajit shtator, i dha lamtumirën anëtarëve të Këshillit së Atlantikut të Veriut dhe stafit të NATO-s më 26 shtator, së bashku me gruan e tij, Anne-Mette dhe vajzën e tij, Christina...

faqe 8-9

NATO

NATO dhe Japonia kryejnë stërvitjen e parë të përbashkët kundër piraterisë

faqe 9

SIGURIA

Burimet e financimit në ekuacionin e të ardhurave të ISIS

faqe 12-13

ANALIZË

Rritja e kërcënimeve kompjuterike

faqe 14

INTERVISTA

Ndjekja dhe harmonizimi i prioriteteve, monitorimi i zbatimit të Dokumenteve Strategjike

faqe 10-11

Intervista e ministres se Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, dhënë për emisionin "Zona B" në Klan Kosova, përballë gazetarit Baton Haxhiu

Mbrojtja nuk është vetëm dhunë, është inteligjencë, strategji, politikë, diplomaci

Mimi Kodheli: Ministria e Mbrojtjes është pjesë e luftës kundër terrorit, pjesë e sigurisë dhe integritetit territorial të vendit dhe e sigurisë së qytetarëve të vet

Ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli dha një intervistë për emisionin "Zona B" në Klan Kosova, përballë gazetarit Baton Haxhiu.

Ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli në emisionin "Zona B" në Klan Kosova

U mundova t'i bëj një përshkrim asaj se si është t'i vesh në rresht meshkujt në një botë, ku së paku shumë të rralla janë femrat që janë ministre të Mbrojtjes…

Në fakt, ka filluar një epokë e re besoj. Unë kam qenë e dyta grua prezente në një tryezë me 28 ministra të Mbrojtjes së vendeve anëtare të NATO-s kur hyra në këtë detyrë, por shpejt u bëmë pesë. Tani janë pesë dhe unë mendoj që ky është një shekull pse jo i grave.

Si është në Bruksel, cila është gjuha që ju përdorni me gjithë ata gjeneralë e njerëz që kanë përvojën në mbrojtje?

Thjesht dhe vetëm drejton politikisht një proces i cili është sa i rëndësishëm aq edhe në dukje i pamundur, por as më të voglin dyshim është një detyrë si të gjithë detyrat e tjera.

Në një botë meshkujsh që merren me ushtri, kanë forcën e dhunën për të rregulluar problemet. Si është pjesa humane e huaja në botën ku përdoret dhuna?

Sot, gjërat kanë ndryshuar besoj. Mendoj që mbrojtja nuk është vetëm dhunë, është inteligjencë, është strategji, është politikë, është diplomaci më së pari. Për fat të keq hyn edhe dhuna, për fat të keq hyn edhe arma, por këto janë mjetet dhe mënyra e fundit le të themi fundore e zgjidhjes së një problemi, zgjidhjes së një konflikti. Bota sot po përjeton një situatë gjeopolitike aspak të këndshme dhe shpeshherë është e vështirë për një grua të marri vendime politike, padyshim dhe ushtarake që kanë të bëjnë me përballjen e dhunës që sot po shohim gjithandej. Gjithsesi i mbetem opinionit që zgjedhja fundore është dhuna. Njerëzit duhet të vazhdojnë të ulen dhe të diskutojnë politikisht për zgjidhjen e problemeve.

E di që meshkujt gjeneralë ose ata që janë në politikën e mbrojtjes në fillim kanë një atitudë përkëdhelëse ndaj jush për shembull, më pas shohin një gjuhë e cila mund të jetë e ashpër ose me butësi të ashpër po aq sa e tyre dhe më pas të merrni vendimet?

Unë besoj që njerëzit janë surprizuar sepse ndoshta është një perceptim që nga jashtë që unë jam një grua e fortë, që di të marr vendime. Ndërkohë që shpresoj shumë që pas një viti pune unë e kam kuptuar qofshin këta gjeneralë ose jo, ushtarakë ose jo që jam një bashkëpunëtore e mirë dhe nuk rri tek e imja, tek fakti që unë bëj ministrin, di të bëj bashkëpunëtorin dhe këtë e bëj përditë dhe ndoshta kjo i ndihmon njerëzit në thyerjen e këtij të qënit ministre e Mbrojtjes grua.

Po kthehemi në një pikë ku është mentaliteti ai që ndikon refuzimin e diçkaje që të gjithë familjet e shqiptarëve e kanë pasur një habi, ministrja e parë femër e Mbrojtjes dhe të gjithë ata që janë pjesë e stafit tuaj mund ta kenë pas një fjali të tipit tashmë një grua do ju udhëheqë. A ke pasur probleme e paragjykime në mentalitet?

Jo dhe nuk jam çuditur për këtë. Mendoj që përzgjedhja e kryeministrit Rama është një përzgjedhje sa e guximshme aq dhe emancipuese. Për aq kohë sa shoqëria shqiptare e ka pranuar këtë gjë krej natyrshëm e normalisht, kuptoj vizionin e kryeministrit për të bërë një gjë jo vetëm të guximshme e jo vetëm për të dhënë një mesazh, por edhe diçka pse jo të pranueshme, sepse në fund të ditës, duke qenë pjesë e qeverisë, kryeministri kërkon që punët të bëhen.

Po përveç kryeministrit, amerikanët ishin më të lumturit që ju u zgjodhët ministre e Mbrojtjes, se një femër në krye të ushtrisë, dozën e saj të humanitetit a mund ta përdorë dhe për gjëra të bukura?

Dhe kjo që thoni ju qëndron. Besoj se Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë partneri ynë kryesor, sidomos kur flitet për pjesën e mbrojtjes dhe ka një dakortësi jo të shkruar, jo vetëm me ta, por me të gjithë ata që sot janë partnerë me të drejta të barabarta të Shqipërisë duke qenë vende anëtarë të NATO-s për arsye që dihen e nuk është e nevojshme t'i përmendim këtu. Nuk e di, ndoshta duhen pyetur zotërinjtë amerikanë pse kanë qenë entuziastë e pozitivë në zgjedhjen që bëri kryeministri Rama në këtë rast, por besoj se kanë parë te qeveria e tek unë si person ndoshta një ndër partnerët më të besuar.

Për ata që ju njohin nuk besoj që janë befasuar me vendimin që është marrë, për arsye se ju njohin edhe nga parlamenti me gjuhën e debatet publike, por desha të kthehem tek një pikë, përvoja juaj me njerëzit të cilët kanë një respekt për oraret, për gjuhën, gjuhë e cila nuk lakohet shumë, nuk është fleksible. Beteja juaj në publik përveç staturës që e ke shumë të kujdesshme, megjithatë ke një gjuhë të pastër edhe me publikun dhe me atë që thua. Si duket përputhja e gjuhës që përdor dhe e gjuhës statike që e kanë gjeneralët dhe stafi që merret me Ministrinë e Mbrojtjes?

Nuk besoj se ka një dallim, ose ka pak dallim midis Mimit politikane dhe Mimit ministre e Ministrisë së Mbrojtjes. E them këtë se ndoshta ju me të drejtë me perceptimin tuaj thoni që gjuha ka qenë shpeshherë e ashpër gjatë gjithë karrierës time politike. Unë mendoj që ka qenë e drejtë përtej mënyrës se si është thënë apo importimit. E di që e vërteta dhe e drejta shpeshherë dhembin, madje tani që flas me ju më vjen ndërmend një batutë e Martin Luter Kingut, i cili thoshte "nuk është e nevojshme të bësh armiq duke u sjellë në një mënyrë të caktuar, mjafton të thuash të vërtetën" dhe kjo besoj që është një postulat universal. Përtej kësaj, kjo vetëm më ka ndihmuar, kjo mënyrë e të bërit të gjërave, kjo mënyrë importimi, kjo rregullsi, kjo disiplinë ka bërë që ndoshta unë të vij deri këtu e të bëj këtë karrierë, besoj pak të kontestueshme ose aspak të kontestueshme, sepse mendoj që kërkohet vullnet i mirë, disiplinë, guxim, për të bërë patjetër edhe ministren e Mbrojtjes, jo vetëm duke qenë grua, por edhe një njeri që rrjedha logjike e të marrit me politikë më ka sjellë deri këtu.

Para se të flasim për armët, për ISIS, më lejoni t'iu pyes, Mimi Kodheli i mban armët, di ti përdorë ato?

Ju falënderoj për këtë pyetje. E dini pse? Unë jam formuar në një regjim ku arma ishte pjesë e trekëndëshit të edukimit, e simbolikës. Sigurisht që njërëzit e brezit tim dinë të gjithë të përdorin ato armë të cilat ne kemi përdorur. Madje kam qenë një person që ka pasur një shënjestër të mirë. Gratë përgjithësisht kanë, ma kanë shpjeguar tani më vonë ekspertët për shkak të frymëmarrjes, emocionet janë më të ftohta në raport me armën se sa meshkujt dhe kjo i bën që të kenë "sy pushke" le të themi më të mirë. Përtej shakasë, jo, nuk i dua armët dhe nuk besoj se gjërat në këtë botë duhet të zgjidheshin nëpëmjet armëve. Ironia e fatit të sjell që të jesh ministër i një dikasteri që armën e ka simbolikën e vet.

Ose të zgjidhësh problemet?

Ose për fat të keq të zgjidhësh problemet.

Atëherë po hyjmë tek kjo pjesë. Ju ishit në një takim, ndoshta në më të rëndëisshmin e kohës, në samitin e NATO-s në Uells. Kryeministri e nisi fjalimin me një imam të Prishtinës dhe burgosjen e tij, por dhe rrezikun që i kanoset rajonit nëse bashkësia europiane dhe NATO nuk janë të kujdesshme në përmbylljen e asaj që quhet europianizim i Ballkanit. Sa rrezik kemi nga ky koncept radikal i islamit politik?

Jetojmë në kohë të vështira dhe të ndërlikuara dhe Ballkani nuk ka nevojë edhe për këtë ngarkesë, sepse ka mjaftueshmërisht problemet e veta dhe pa e pasur këtë që për fat të keq është prezente. Është prezente në Kosovë, në Maqedoni, Shqipëri ose më shumë se kaq. Edhe në Serbi është shumë prezente, është e vërtetë, madje edhe në Bosnje. Unë ndaj me ju pikërisht atë që qeveria shqiptare nëpërmjet kryeministrit Rama ka ndarë në atë që ju me të drejtë e quani një ndër ngjarjet më të rëndësishme, në mos ngjarja më e rëndëisishme politike e vitit që ishte samiti i Uellsit. Bota shqiptare duhet ta shikojë të ardhmen e fëmijëve të vet nëpërmjet një procesi që është ai i integrimit në Bashkimin Europian dhe këtë pa dyshim duhet e mund ta bëjë nëpërmjet refuzimit që i bëhet këtij ekstremizmi, refuzimit dhe luftës ndaj elementëve keqdashës, që nuk kanë të bëjnë fare me religjionin, fare fare. Ndaj ne duhet të jemi shumë të vëmendshëm nëpërmjet strukturave të cilat merren me këtë punë. Ministria e Mbrojtjes nëpërmjet strukturave të veta ka pjesën e saj të rëndësishme dhe shpresoj shumë që rastet të jenë sporadike, ky fenomen të mos jetë i përmasave që më pas do të ishin të papëlqyeshme e të pakëndshme për këdo. Përgjigja që ne kemi dhënë,

STAFI

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**
Alba **MUSARAJ**

Redaktore korrektore:
Elona **SHIMAJ MAKO**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës

përgjigja që Kosova ka dhënë, përgjigja që Shqipëria jep dhe përgjigja që të gjithë trevat shqiptare dhe jo vetëm duhet të japin brenda shteteve të tyre duhet të jetë një dhe e vetme: Jo, këtij lloj ekstremizmi dhe këtij lloj fenomeni që askënd nuk e con askund përvecse në një botë e cila nuk mund të jetë bota që ëndërrojmë për fëmijët tanë.

A është e mjaftueshme kjo? Megjithatë, kjo situatë do veprime konkrete. Nuk po flasim vetëm për arrestimet që janë bërë në Kosovë, por meqë Maqedonia është ndarë në dy pika kryesore të reduktimit që kanë arritur pikën kulminante të dukshmërisë. Maqedonia si shtet vështirë të merret me atë punë dhe i le shqiptarët në botën e tyre të radikalizmit islam e të mos përzihen me punët shtetërore, i le në periferi të kulturimit dhe Shqipërisë i mbetet ta mbikqyrë këtë situatë?

Unë mendoj që radikalizmi hyn kudo ku shteti nuk është prezent ashtu siç thatë edhe ju. Kudo ku ka varfëri. Kudo ku qytetari nuk e ndjen prezencën e shtetit me shërbimet, me mundësinë për t'u punësuar, me mundësinë për t'u shkolluar e do të jetë gjithnjë kështu nëse do ta lemë këtë pjesë të popullsisë e këtë situatë të jetë në dorën e tjetërkujt. Ju keni të drejtë. Ka disa mënyra për ta luftuar këtë gjë. Ka disa mënyra për të mos e mundësuar këtë fenomen që të kthehet në një problem shumë të madh për vendet tona, për rajonin tonë, por dhe më shumë se kaq. Duke filluar pa dyshim nga arsimimi i njerëzve, nga dhënia e mundësisë për t'u punësuar, por duke pasur në vëmendje dhe proceset integruese në të cilat është rajoni jonë. Shqipëria është vend anëtar i NATO-s e duhet të luftojmë fort që Maqedonia të zgjidhë problemet e saj për të mundësuar anëtarësimin, që Kosova fort të shtyhet në rrugën ku tashmë pa kthim qëndron, që është rruga drejt anëtarësimit, megjithë që shikohet larg dhe pa dyshim rruga si drejt anëtarësimit në NATO dhe ajo në BE. Këto janë të vetmet mjete e mënyra për të mundësuar një zbehje, një zbutje të këtij fenomeni, i cili ju them nuk është një problem, por do të kthehet në të tillë nëse nuk marrim masat e nevojshme për ta eliminuar.

Ju përdorët fjalën nëse dhe kjo fjalë nuk është e mjaftueshme për të rregulluar çdo problem. Po flasim konkretisht për ministrinë tuaj. E di që do më thoni që kjo është çështje e sigurisë së vendit, e policisë, e inteligjencës. Megjithatë, ky problem shkon përtej saj. Problemi ndoshta është më akut se gjithçka tjetër, megjithëse e drejta e fjalisë po keqpërdoret. Është shumë e vështirë t'i thuash njerëzve pse përdor fjalinë për të bindur të tjerët. Midis lirisë së fjalës dhe fjalës për urrejtje duhet ta keni një projekt dhe me ata të ministrisë tuaj…

Ne projektin e kemi, punojmë çdo ditë për ta bërë këtë gjë. Do t'i rrimë fort qëndrimit tonë në luftën kundër radikalizmit. Do t'i rrimë fort luftës se kujtdo që mbjell urrejtjen, që mbjell një farë e cila nuk i takon tokës shqiptare. Si të kthejmë kokën mbrapa në histori, si të shikojmë përpara në të ardhmen. I kemi dhe do t'i luftojmë. Lufta e së mirës me të keqen është një luftë që do të vazhdojë siç edhe ka qenë. Ne duhet absolutisht të dalim të fituar nga kjo gjë. Dhe nga kjo të fituar dalin shqiptarët, del rajoni, del siguria, del e ardhmja dhe këtë do ta bëjmë fort ashtu siç kemi treguar që jemi duke e bërë. Problemi i radikalizmit nuk është vetëm fakti që sa është numri i atyre që sot largohen nga Shqipëria dhe shkojnë të luftojnë diku tjetër. Problemi është që kur ata kthehen pranë familjeve të tyre, cili është qëndrimi që duhet të mbajë shoqëria në raport me ta dhe ky është një tjetër fenomen me të cilin ne duhet të përballemi si politikë, si shoqëri.

Si duhet të rekrutohen njerëzit që janë mësuar me dhunë, më ashpërsi, me vrasje. Çfarë duhet të bëjë shoqëria? Dhuna po të trajtohet me butësi vështirë se mposhtet. Nuk e di a kemi ne si shoqëri aq shumë mirëqënie sa ta fitojmë betejën me dhunë?

Jo, nuk e kemi dhe ju keni të drejtë. Lufta me mirëqënie është një pjesë e përballjes së kësaj barbarie, nëse më lejohet ta them këtë fjalë. Duhet të ketë një strategji të plotë që duhet të ketë në përbërje të saj mirëqënien, shkollimin, investigimin, luftën nëse është e nevojshme, përgjigjen ushtarake ndaj fenomenit brenda suazës NATO dhe gjithçka tjetër që do ta ndihmojë këtë fenomen të mos përhapet më shumë.

Ky po bëhet katërkëndësh duke përfshirë edhe vijën gati të gjelbër deri në Bosnje, e cila kap një numër gati prej 3.600-4.000 që luftojnë në Siri. Është një ushtri e tërë, megjithatë asnjë polici nuk mund ta fitojë betejën po nuk e fitoi betejën popullata e vet. Beteja i takon një strategjie që duhet ta bëjë ministria juaj. Strategjia për të ardhmen është lufta me 4.000 njerëz të cilët kanë luftuar atje e një ditë lufta do përfundojë?

Ministria e Mbrojtjes është pjesë e strukturave që duhet të dialogojnë dhe të merren me këtë gjë. Ka dhe struktura të tjera të shtetit që janë akoma më në front të parë sesa Ministria e Mbrojtjes. Sepse në fund të ditës Ministria e Mbrojtjes është pjesë e luftës kundër terrorit, është pjesë e sigurisë dhe integritetit territorial të vendit, por dhe e sigurisë së qytetarëve të vet dhe e koordinuar kjo edhe me të gjitha strukturat e tjera, Ministrinë e Brendshme, Shërbimet e Inteligjencës dhe të gjitha strukturat e tjera që janë përgjegjëse. Ky është një fenomen jo vetëm i joni dhe i Ballkanit, ato mijërat që ju përmendët me të drejtë vijnë edhe nga vendet perëndimore, siç mund të jetë Britania apo Franca, etj. Unë mendoj që strategjia duhet të jetë e përbashkët e vendeve të BE-së, vendeve të NATO-s dhe të gjithë vendeve pa përjashtuar as vendet me background mysliman, që sot janë ngritur dhe janë bërë partnere të të gjitha operacioneve.

Deri ku i siguron Ministria e Mbrojtjes qytetarët e saj?

Njerëzit nuk duhet të kenë frikë, duhet të jenë të qetë dhe të vazhdojnë ashtu siç kanë vazhduar ditën dhe javën e tyre, sepse unë ju siguroj që ky nuk duhet të jetë një problem shqetësues për shoqërinë shqiptare, por shoqëria duhet dhe të vetëndihmohet në këtë gjë, të ketë vetëpërqasjen e saj ndaj këtij fenomeni. Duhet të bëjë një përqasje, e cila duhet të shkojë ashtu siç dhe shkon ky fenomen brenda gjithsecilit, nga ato njerëz të zhgënjyer tek e cila futet urrejtja ashtu duhet të shkojë edhe përqasja pozitive ndaj shoqërive. Shqiptarët kanë ditur të përballen me këtë fenomen. Shqipëria, shqiptarët në rajon, në Kosovë, në Maqedoni janë të pjekur për të qenë akoma bashkë për ta ndihmuar veten e tyre. Është një përballje që do të vazhdojë të jetë, por është e sigurtë që do të fitojë shqiptarizmi dhe qytetarimi.

Nëse doni t'ju çojmë disa ekspertë të Ministrisë së Mbrojtjes në Kosovë për të kuptuar sesi do përparojës FSK në rrugën e saj drejt integrimit unë mund ta bëj me kënaqësi, por kjo ishte sa për batutë. E shikoj shpëtimin, duke u munduar maksimalisht që procesi integrues të vlerësohet si shumë i rëndësishëm. Të qenit nesër partner i NATO-s do ta ndihmojë shumë procesin, sepse ti nuk je më vetëm, ti je bashkë me të tjerët dhe kjo do të japë padyshim më shumë siguri, ashtu siç i jep siguri sot Shqipërisë të qenit anëtar i NATO-s.

Jeni anëtar i NATO-s dhe natyrisht ndani informacione, ju shoh që jeni e shqetësuar, me siguri kolegët tuaj të gjithë botës ju japin mjaftueshëm informacione sa të mos ndiheni të vetmuar në këtë process?

Absolutisht që po, është shumë e rëndësishme që ta ndaj edhe me publikun, sepse këtu ka pasur probleme të cilat i kanë rrudhur shërbimet e inteligjencës brenda Ministrive të Mbrojtjes, të vendeve të NATO-s në vitet më parë, e kanë rrudhur komunikimin, besimin dhe kjo ka qenë e vështirë në punën time për ta rifituar këtë gjë nga e para. Sot ndahet në mënyrë absolute çdo gjë, jo vetëm me vendet e NATO-s, por ndahet edhe me shërbimet në Kosovë, Maqedoni dhe gjetkë. Punohet në drejtimin e duhur, madje punohet shumë mirë.

Ka më shumë se 1 vit që jeni në zyrën e ministres së Mbrojtjes. Çfarë i numëroni opozitës si pozitive dhe negative. A i njihni ndonjë meritë opozitës për ndonjë punë dhe për procesin e hyrjes në NATO?

Është e vështirë të mund të kristalizohet ajo që opozita sot përfaqëson, në mënyrë kush sot qeveris, maxhoranca të mund të konfrontojë atë çka opozita ka pozitive dhe atë çka maxhoranca bën sot, këto të dyja të përballen dhe të shikohet se ku jemi të dyja palët, për shkak se opozitës i është dashur pak të dalë nga shoku i humbjes së zgjedhjeve, për fain e tyre e quaj shok, sepse shikoj që kanë menduar në disa raste që do të rrinin disa dekada të qeverisnin dhe kjo nuk është shenjë e mirë e demokracisë, por dhe për faktin se në mundim e sipër për tu riorganizuar nuk kanë bërë më të mirë brenda tyre. Unë në përgjithësi jam një politikane që nuk para bëj komente për jetën e brendshme të partisë sot në opozitë, më intereson më shumë produkti që ata nxjerrin.

Dhe hallet e tyre?

Halle dhe borxhe kanë lënë shumë dhe në vitin e parë qeverisës më shumë jemi munduar të shlyejmë borxhet dhe të rregullojmë hallet që na kanë lënë, sesa të bëjmë punët që duheshin bërë.

Kjo do të thotë që mund të bëhen gabime duke qenë e kondicionuar prej kushteve që ju kanë lënë ato?

Unë kam gjetur 16 milionë euro borxhe, fatura të papaguara kur erdha dhe kur je përballë një fature të tillë është e vështirë të mendosh strategjikisht se çfarë janë gjërat që NATO kërkon e që ti nuk i ke bërë, por megjithatë kam bërë brenda një viti një gjë që ishte premtuar dhe nuk ishte bërë kurrë, e kam zhveshur ushtrinë shqiptare nga kallashnikovi sovjetik dhe do ta "vesh" me armatimin e standardit NATO më modern në treg.

Si ka mbetur kallashnikovi?

Ka mbetur sepse mesa duket zotërinjtë kishin gjëra më të rëndësishme për të bërë dhe jo atë që ishte obligimi primar i FA të Shqipërisë në raport me NATO-n, përgatitja e një batalioni këmbësorie me të gjithë armatimin për të qenë i gatshëm në çdo operacion ku NATO e kërkon. Është e thjeshtë, por problemi është që kur nuk ke fokusin të bësh gjërat që të kërkohen për të bërë, por bën gjëra të tjera, problemi komplikohet. Ne brenda këtij viti do ta realizojmë këtë gjë, sigurisht edhe me ndihmën e rialokimit që është bërë nga ana e qeverisë që kaloi një javë më parë në Parlament, pra me paratë që qeveria na besoi dhe që e mendoi si të rëndësishme këtë, sidomos duke parë situatën në të cilën ndodhemi. Ne lundrojmë në ujëra të turbullta sot dhe na duhet të jemi të përgatitur për këtë.

Cili është qëndrimi juaj profesional dhe informativ që keni për atë që Kosova tashmë e quan Forcë të Mbrojtjes së saj, ushtrinë e saj. Çfarë ka brenda një ushtri e porsa formuar ose një ushtri e dalë nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës e transformuar. A ka arritur pika ku duhet respektuar?

Ka shumë rrugë për të bërë, por ajo çka është shumë e rëndësishme, ka fillimin e drejtë dhe të duhur. Kjo është shumë e rëndësishme. Gjithë popujt në botë kanë një proverb të përbashkët, fillimi i mirë është gjysma e punës dhe kjo është shumë e rëndësishme për FSK-në. Lidershipi gjithashtu ka qenë i rëndësishëm dhe më duhet ta falenderoj nga zemra ministrin Çeku për të gjithë punën që ka bërë dhe këtë nuk e them se ne jemi këta vëllezërit dhe kolegët që jemi, por e them sepse e meriton. Sigurisht, ka qenë i mbështetur nga qeveria e tij për ta bërë, por ka disa qëndra të përgatitjes që janë shpesh herë edhe më të mira sesa ata që ne kemi këtu. A ka hapa dhe rrugë për të bërë? Padyshim që ka, por në qoftë se fillimi është i mirë dhe kjo strukturë ndihet e sigurtë në gjërat që është duke bërë.

Klan Kosova e ka një slogan: Jemi një. Ku jeni një, ju dhe ministri Çeku, ministria dhe ushtria dhe ku jeni dy?

Ne jemi një, në luftën për të realizuar atë që është në fund të fundit misioni i vetëm dhe një i kësaj strukture, mbrojtjen e qytetarëve shqiptarë, integritetin dhe të ardhmen. Jemi dhe do të jemi gjithmonë një. Jemi dy si struktura, sepse duhet të jemi dhe do punojmë dyshe për ta marrë këtë strukturën e re dhe për ta vendosur në tryezën që i takon në një të ardhmeje besoj jo fort të largët.

Gazetari Baton Haxhiu

"Detyra dhe besim i madh që u është dhënë duhet të kryhet me nder dhe përkushtim"

Shtabi i Përgjithshëm i FA shtron drekë për familjarët e ushtarakëve

Gjeneralmajor Jeronim Bazo: "Sot është koha që edhe ne t'ju shërbejmë juve po me të njëjtin përkushtim siç ju i keni shërbyer atdheut"

Në mjediset e batalionit të Forcave Speciale në Zall-Herr drejtuesit e Forcave të Armatosura shtruan një drekë për fëmijët e familjarët e ushtarakëve.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin: ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, drejtues të Shtabit të Përgjithshëm, komandantë forcash dhe batalionesh autonome.

Ministrja e Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, përmes këtij aktiviteti social me fëmijët dhe të afërmit e ushtarakëve, i falënderuan ata për kontributin e vyer që japin në shërbim të atdheut, duke shërbyer me përkushtim dhe sakrificë si brenda dhe jashtë vendit.

Gjeneralmajor Jeronim Bazo, falënderoi familjarët e ushtarakëve për mbështetjen e pakufijshme për të afërmit e tyre që punojnë në radhët e Forcave të Armatosura. Gjithashtu, duke iu drejtuar ushtarakëve të pranishëm në aktivitet, ai theksoi se: "Në çdo lloj detyre që shërbeni, ju së pari i shërbeni atdheut dhe kërkoj prej jush që kjo detyrë dhe besim i madh që u është dhënë duhet të kryhet me nder dhe përkushtim". Gjeneralmajor Bazo, shprehu mbështetjen edhe të lidershipit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FA për një kujdes më të mirë ndaj ushtarakëve dhe familjarëve të tyre. "Sot është koha që edhe ne t'ju shërbejmë ju po me të njëjtin përkushtim siç ju i keni shërbyer atdheut", - nënvizoi gjeneralmajor Bazo. Me këtë rast ai preferoi t'i shërbejë të ftuarve dhe ministres Kodheli.

Ministrja e Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, përmes këtij aktiviteti social me fëmijët dhe të afërmit e ushtarakëve, i falënderuan ata për kontributin e vyer që japin në shërbim të atdheut, duke shërbyer me përkushtim dhe sakrificë si brenda dhe jashtë vendit. Gjeneralmajor Jeronim Bazo, falënderoi familjarët e ushtarakëve për mbështetjen e pakufijshme për të afërmit e tyre që punojnë në radhët e Forcave të Armatosura.

Atasheu ushtarak i Kosovës, n/kolonel Enver Dugolli, vizitë në Brigadën Logjistike

Zëvendëskomandanti i Brigadës Logjistike, kolonel Fatmir Lokaj ka pritur në një takim kortezie atasheun ushtarak të Kosovës, n/kolonel Enver Dugolli. Kolonel Lokaj pasi i uroi mirëseardhjen n/kolonel Dugollit, e njohu shkurtimish me strukturen, misionin, detyrat dhe mbështetjen logjistike të Forcave të Armatosura dhe shprehu bindjen se bashkëpunimi ndërmjet dy vendeve në fushën e mbrojtes do të vazhdojë dhe në të ardhmen.

Atasheu ushtarak i Kosovës, n/kolonel Enver Dugolli, e falenderoi kolonel Lokaj për mikëpritjen e ngrohte dhe miqësore, duke vlerësuar bashkëpunimin e frytshëm që ekziston midis dy vendeve tona.

Nga ana e tij, kolonel Lokaj shprehu kënaqësinë dhe gatishmërinë për të punuar dhe kontribuar në interes të përmbushjes së objektivave të përbashkëta.

SHKURT

Anija e Rojes Bregdetare , ARCHAngel, P-02 shpëton ekuipazhin e peshkatores "ANA"

Në orën 04.30, anija e gatëshme, Archangel P-02 me vendbazim në ishullin e Sazanit mori një sinjal nga QNOD, {Qendra Operacionale Ndërinstitucionale Detare}, se trageti i linjës Vlorë-Bari "Europian Voyager Limassol", në distancën 2.3 milje në Jugperëndim të kepit të Sazanit, ka goditur aksidentalisht peshkatoren "ANA", {port regjistrimi Durrës}, me pasojë mbytjen e peshkatores. Menjëherë Anija P-02, me Komandant KapitenLt. Elton Kasëmi shkoi në vendin e ngjarjes për kërkimin dhe shpëtimin e peshkatores me kapiten Qemal Lata, dhe ekuipazh Aranit e Julian Lata. Peshkatorja pas përplasjes ishte zhytur menëhere në thellësitë e Jonit dhe 3 peshkatarët qëndronin mbi zadren e shpëtimit. Mbas goditjes Trageti ndaloi dhe nisi kërkimin për gjetjen e njerëzve në det. Në oren 05.18 anija e Rojës Bregdetare , P-02 pas kërkimeve të kryera gjeti zadrën me tre peshkatarët dhe i solli në portin e Vlorës, jashtë rrezikut për jetën. Ndërkohë nga komandanti i anijes së RB u plotësua dokumentacioni përkatës dhe deklarata e peshkatarëve. Tashmë institucionet e tjera shtetërore të qytetit Vlorë po kryejnë procedurat përkatëse për të tilla raste.

SH.K.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Jeronim Bazo, vizitë zyrtare në Greqi

Shqipëri-Greqi, bashkëpunim i frytshëm ushtarak

Gjeneral Kostarakos thekson gatishmërinë e Greqisë për të mbështetur Shqipërinë në rrugën e anëtarësimit në BE

Në datën 29 shtator 2014, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Jeronim Bazo zhvilloi një vizitë zyrtare në Greqi. Kjo vizitë është vijim i bashkëpunimit ushtarak në rritje ndërmjet dy vendeve sidomos në fushën e arsimim-edukimit, stërvitjeve të përbashkëta dhe pjesëmarrjes në iniciativat rajonale si "Iniciativa e shefave të Shtabit të Përgjithshëm të Ballkanit", SEDM, SEEBRIG, etj.

Gjatë kësaj vizite, shefi i Shtabit të Përgjithshëm zhvilloi takime me ministren Plotësuese të Mbrojtjes të Greqisë, znj. Fofi Gennimata, shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA të Greqisë, gjeneral Mikhail Kostarakos dhe takime në Akademinë e Forcave Tokësore të Greqisë. Gjatë takimeve u vlerësua bashkëpunimi ushtarak midis dy vendeve dhe rritja e këtij bashkëpunimi në të ardhmen, si edhe u vlerësua roli i Greqisë për mbështetjen e dhënë gjatë rrugëtimit drejt NATO.

Gjatë takimit gjeneral Kostarakos ka theksuar gatishmërinë për mbështetjen e Greqisë për anëtarësimin e Shqipërisë në BE. "Ju mbështesim në rrugën tuaj drejt së ardhmes, pasi është receta më e mirë për stabilitetin në rajon dhe më gjerë". Më tej, gjeneral Kostarakos u shpreh se dy kombet tona kanë jetuar së bashku për mijëra vite, që prej fillimit të historisë njerëzore. Ata nuk erdhën prej ndokund dhe nuk përzunë ndokënd. Kemi ndarë të njëjtin fat së bashku

GJENERAL KOSTARAKOS

"Dy kombet tona kanë jetuar së bashku për mijëra vite, që prej fillimit të historisë njerëzore. Ata nuk erdhën prej ndokund dhe nuk përzunë ndokënd. Kemi ndarë të njëjtin fat së bashku përgjatë historisë, kemi vuajtur së bashku, kemi gëzuar së bashku dhe kemi luftuar së bashku, por asnjëherë kundër njëri-tjetrit"

përgjatë historisë, kemi vuajtur së bashku, kemi gëzuar së bashku dhe kemi luftuar së bashku, por asnjëherë kundër njëri-tjetrit".

Nga ana e tij gjeneral Bazo pasi vlerësoi bashkëpunimin ushtarak të dy vendeve dhe mbështetjen e dhënë për anëtarësimin në BE, theksoi se "Fakti që jemi këtu ku jemi përgjatë historisë tregon se ne dimë të jetojmë së bashku". Greqia përveç të tjerave ka qenë një mbështetëse e fuqishme në fushën e arsimimit dhe edukimit ushtarak.

Gjatë takimit, gjeneral Kostarakos dhe gjeneral Bazo kanë vënë theksin në rëndësinë e stërvitjeve të përbashkëta, sidomos në kuadër të NATO-s dhe iniciativave rajonale duke nënvizuar faktin se sa më shumë stërvitemi së bashku aq më i qartë është mesazhi që ne japim në fushën e bashkëpunimit ushtarak dhe për rrjedhojë edhe në marrëdhëniet midis dy vendeve tona.

Vizita zyrtare e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Jeronim Bazo dhe delegacionit që e shoqëronte në Greqi është përmbyllur me takimin me studentët shqiptarë që studiojnë pranë Akademisë së Forcave Tokësore greke.

Ndjehemi krenarë që punuam së bashku

U zhvillua ceremonia me rastin e daljes në rezervë të komandantit të Forcës Ajrore, gjeneral brigade Frederik Beltoja

Në ambientet e Bazës Ajrore Farkë, më datën 26 shtator 2014 u zhvillua ceremonia e daljes në rezervë të komandantit të Forcës Ajrore, gjeneral brigade Frederik Beltoja. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, merrnin pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Jeronim Bazo, zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Viktor Bërdo, komandantë të forcave, zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Mehmet Metko, drejtorë drejtorish në SHPFA, si dhe ushtarakë të Forcës Ajrore.

Fjalën e rastit e mbajti zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Mehmet Metko, i cili ndër të tjera evidentoi punën dhe kontributin e dhënë nga gjeneral Beltoja në rrugën e zhvillimit dhe modernizimit të Forcës Ajrore. "Ne ndjehemi krenarë që punuam krah teje në reparte të ndryshme të Forcës Ajrore, por edhe të trishtuar që nuk do ta kemi më lidershipin dhe ndihmën tuaj në zhvillimin dhe modernizimin e mëtejshëm të Forcës Ajrore. Më lejoni që t'ju shpreh mirënjohjen dhe falënderimet e mia dhe të gjithë Forcës Ajrore për gjithçka keni bërë".

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Jeronim Bazo, në fjalën e tij vlerësoi punën dhe kontributin e gjeneral Beltos si pilot, por edhe si drejtues i Forcës Ajrore. Ai shprehu mirënjohje dhe respekt për mbështetjen që gjeneral Beltoja i ka dhënë Forcës Ajrore në zbatimin e projekteve moderne dhe ambicioze.

Ndërsa gjeneral brigade, Frederik Beltoja në fjalën e tij falënderoi shefin e Shtabit të Përgjithshëm dhe kolegët për bashkëpunimin në interes të zhvillimit dhe modernizimit të Forcës Ajrore. Ai shprehu mirënjohjen për të gjithë personelin e Forcës Ajrore, të cilët me punën e tyre të përditshme bëjnë të mundur ecjen përpara dhe arritjen e standardeve të NATO.

Shqipëria dëshmon se është në krah të mbrojtjes së vlerave të demokracisë dhe paqes

Përfundon me sukses operacioni në ndihmë të qeverisë së Irakut

Ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli, u ka dërguar një letër falënderimi të gjithë homologëve të saj të vendeve që kontribuan në këtë operacion. Znj. Kodheli falënderon Qeverinë dhe Forcat e Armatosura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Mbretërisë së Bashkuar, Kanadasë, Danimarkës dhe Australisë.

Ministria e Mbrojtjes informon opinionin publik, nëpërmjet deklaratës së saj të datës 26 shtator 2014, se ka përfunduar me sukses operacioni i dërgimit të ndihmës me armë dhe municione në ndihmë të qeverisë së Irakut. Shqipëria edhe një herë tjetër dëshmoi se është në krah të mbrojtjes së vlerave të demokracisë dhe paqes. Me këtë rast, ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli, u ka dërguar një letër falënderimi të gjithë homologëve të saj të vendeve që kontribuan në këtë operacion. Znj. Kodheli falënderon Qeverinë dhe Forcat e Armatosura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Mbretërisë së Bashkuar, Kanadasë, Danimarkës dhe Australisë.

Certifikohen instruktorët e EOD-së niveli i parë nga ekipi i gardës së New Jersey-t

Me datë 26.09.2014 në ambientet e Qendrës së Asgjesimit të Municioneve dhe Eksplozivëve u zhvillua ceremonia e çertifikimit të Instruktorëve të EOD-së niveli i I-rë nga Instruktorët e Gardës Kombëtare të New Jersey-it. Në ketë ceremoni morën pjesë Shefi i Shtabit i Brigadës Logjisike kolonel Lulëzim Xhafa, Komandanti i Qendrës AME nënkolonel Ajet Dalti, Shefi i Zyrës së ODC-së major Kristopher Mitchell, Menaxheri i Zyrës së ODC-së z. Artian Dautaj, Drejtori i kompanisë AMMCO z. Arben Braha si dhe Instruktorët e Gardës së New Jersey-t kapter David Neidzwiadek, tetar John Hurley dhe tetar Raymond Wayne.

Instruktorët e EOD morën pjesë në trajnimin dy javor që u zhvillua i kombinuar në teori dhe praktike, teoria është zhvilluar në ambientet e Pezë Helmësit ndërsa praktika është zhvilluar në Pezë Helmës dhe poligonin "Shën Noi i Madh" Bizë.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte përgatitja e Instuktorëve të ardhshëm EOD niveli I-rë me synim ngritjen e kapaciteteve kombëtare për të trajnuar opertaorët EOD, të cilët do të angazhohen në operacione të asgjesimit të municioneve konvencionale, pastrimin e zonave të infektuara me municione të paplasura dhe pastrimin e grup depove të municioneve.

Në trajnim morën pjesë 10 efektive të togës së EOD e deklaruar në "NATO POOL OF FORCES" e cila është duke u vlerësuar sipas sistemeve CREVAL (combat readiness evaluation).

Shefi i zyrës së ODC major Kristopher Mitchell duke falenderuar Instruktorët e EOD-së niveli I-rë dhe Instruktorët e Gardës së New Jersey-t, u shpreh se EOD shihet tashmë nga SHBA dhe NATO si një njësi përbërëse e rëndësishme për rajonin e ballkanit pasi ajo ka dhënë kontributin e saj dhe në Bosnje Hercegovinë, gjithashtu ai falenderoi togën EOD për ndihmën që jap ndaj popullsisë civile për pastrimin e municioneve të paplasura dhe hot spoteve.

Më pas Shefi i Shtabit i BrL kolonel Xhafa falenderoi Shefin e Zyrës së ODC për ndihmën e dhënë në vazhdimësi, Instruktorët e Gardës së New Jersey-t për bashkëpunimin dhe efektivin e EOD-së për përkushtimin e treguar.

Ceremonia u mbyll me një foto të përbashkët.

Aksidentet në Shqipëri, pse ndodhin kaq shumë?!!

Krahasuar me vendet e Bashkimit Evropian në Shqipëri ndodhin dyfish i aksidenteve automobilistike, jo vetëm në raport me numrin e popullsisë, por edhe me numrin e automjeteve që janë në qarkullim.

Çdo vit, për çdo një milion banorë në Shqipëri, raportohen se humbasin jetën në aksidente automobolistike 119 shtetas, ndërkohë që në vendet e Bashkimit Europian humbasin jetën në aksidente automobolistike 40 deri në 60 shtetas. Që nga viti 1992 deri në vitin 2013 në Shqiperi kanë humbur jetën në aksidentet automobilistike 6.939 persona. Vihet re një trend në rritje i aksidenteve automobilistike, të cilat për këtë hark vitesh kanë regjistruar shifrën e 19.441 aksidente, pjesa dërrmuese e tyre të mbyllur me të plagosur e të gjymtuar. Nëse do t'i referohemi raporteve policore, në mënyrë sistematike është thënë se shkaku kryesor i aksidenteve, është shpejtesia tej normave të lejuara apo shkelja e rregullave nga drejtuesit e mjeteve. Por në listë radhiten një sërë faktorësh që ndikojnë në shkaktimin e aksidenteve. Nga verifikimet dhe studimet e kryera në terren së bashku me veteranin e ekspertëve autoteknik z. Gezim Hoxha dhe Ing. Erion Skënderi themi se faktori rrugë, cilësia dhe mungesa e sinjalistikës janë elemente që janë shkaktarët kryesore të aksidenteve.

Nga verifikimet e bëra në terren konstatohet se projektet në zbatim lihen përgjysmë dhe shfrytëzimi i rrugëve fillon pa përfunduar rruga ose kur ka probleme të mëdha teknike. Rrugët merren në dorëzim pa përfunduar dhe në disa raste pa raportin e supervizorit. Shpesh supervizorët, thotë raporti, janë përfaqësues të investitorit dhe që këtu fillon konflikti i interesit".

Nga statistikat, rreth 10 për qind e aksidenteve bëhen në rrugë të lagura duke qenë se akset rrugore mbajnë pellgje me ujë. Si shkak i dytë i aksidenteve radhitet rritja e numrit të mjeteve motorrike e për rrjedhojë kjo rritje e numrit pa u paraprirë nga planifikime të mirëfillta të zonave urbane dhe në mungesë të aksesit për këmbësorët dhe biçiklistët, çon në rritjen e rrezikut të tyre në përfshirjen në aksidente rrugore dhe uljen gjithnjë e më shumë të numrit të udhëtimeve të pamotorrizuara dhe të transportit publik.

Më tej, evidentojmë mungesën e ndriçimit publik në rrugët nacionale. Si faktor për aksidentet vijohet më tej me pasigurinë e automjeteve, pasi tregu vijon të dominohet nga mjete të përdorura. Ndërkohë që për shpejtesinë dhe përdorimin e alkoolit theksoj se vijojnë të jenë problem serioz që sjell përfshirje në aksidente, sikurse edhe përdorimi i telefonit gjatë drejtimit të automjetit, por edhe mungesa e edukatës së duhur nga përdoruesit e rrugës.

Për të ulur numrin e lartë të aksidenteve në vend unë si ekpserti i sigurisë rrugore mendoj se duhet rishikuar sinjalistika rrugore, në veçanti në akset që janë në ndërtim. "Përmirësimi i sinjalistikës në rrugët e banuara është imediate. Gjithashtu, drejtuesit e mjeteve duhen edukuar që të lëvizin sipas sinjalistikës. Të gjejmë një zgjidhje teknike dhe projektuese, në mënyrë që drejtuesi të ecë sipas filozofisë së sinjalistikës. Nëse marrim si shembull nyjet kryesore, ato janë ende kantiere ndërtimi dhe kanë nevojë për sinjalistike paralajmeruse. Por përpara se të merren masa duhet të ketë një studim të thelluar që tregon shkaqet e vërteta të aksidenteve. "Numri më i madh i aksidenteve është në qendra urbane. Duhet një analizë, që ta stiudiojmë aksidentin rrugor, karakteristikat e tij dhe të marrim masat. Të shohim ku kemi arritur përmes kësaj analize. Por gjithashtu do të ishte i domosdoshëm rinovimi i transportit urban, që do të zgjidhte shumë punë. Ndërsa prej vitesh flitet për pikat e zeza ku ndodhin më shpesh aksidente, ato vijojnë të jenë një burim rreziku. "Kam konstatuar se në 23 vjet në vendin tonë aksidenti është parë vetëm si statistikë dhe nuk është bërë ajo që duhet për ta evituar. Duhet parë se si të heqim pikat e zeza të rrezikut, pastaj ta shohim aksidentin si statistikë duke e krahasuar me vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim".

Megjithatë nuk mund të hedhim poshtë punën e qindra vajzave dhe djemve të cilët punojnë çdo ditë në rrugë për parandalimin e aksidenteve automobilistike dhe rritjen e sigurisë rrugore në vend, këtyre personave ju kushtoj një falenderim të veçantë FALEMINDERIT!

Ing. Fisnik Ziçishti
Eksperti Sigurise Rrugore

Rasmussen i thotë lamtumirë Këshillit të Atlantikut të Veriut dhe stafit të NATO-s

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, i cili u largua zyrtarisht si Sekretari i Përgjithshëm i 12 i Aleancës, në fund të muajit shtator, i dha lamtumirën anëtarëve të Këshillit së Atlantikut të Veriut dhe stafit të NATO-s më 26 shtator, së bashku me gruan e tij, Anne-Mette dhe vajzën e tij, Christina.

Në një ceremoni lamtumire, ku morën pjesë zyrtarë të lartë së Aleancës dhe oficerë ushtarakë, Sekretari i Përgjithshëm vendosi një kurorë në Memorialin e NATO-s për të rënët, në selinë e NATO-s në Bruksel, për të nderuar burrat e gratë që bënë sakrificën e fundit në operacionet dhe misionet e udhëhequra nga NATO.

Duke iu drejtuar Këshillit së Atlantikut të Veriut për herë të fundit, ai i përshkroi burrat e gratë në uniformë, të cilët mbrojnë sigurinë dhe vlerat tona nën flamurin e NATO-s, si "shtylla kurrizore e Aleancës tonë". Ai falënderoi ambasadorët dhe delegacionet e 28 vendeve aleate si dhe të gjithë anëtarët e Stafit Ndërkombëtar të NATO-s dhe Stafit Ushtarak Ndërkombëtar, për dedikimin, profesionalizmin dhe punën e shquar në grup gjatë mandatit të tij, të cilin ai e përshkroi si "vitet më të ngarkuar dhe sfidues për NATO-n". Ai theksoi se aftësia e NATO-s për të ndryshuar dhe për t'u përshtatur është ajo që e bën Aleancën kaq të fortë. "Ne e kemi përforcuar Aleancën për ta bërë atë më të shpejtë dhe më fleksibël", u shpreh Rasmussen.

Kryeministri i parë që u bë Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, u emërua nga udhëheqësit e Aleancës në samitin e Strasburg-Kehl, në vitin 2009, kur ai ishte kreu i Qeverisë së Danimarkës. Ai e mori detyrën më 1 gusht të vitit 2009. Gjatë qëndrimit të tij, Rasmussen mbikëqyri misione të njëkohshme dhe operacione në tre kontinente. Në vitin 2010, në samitin e Lisbonës, NATO miratoi Konceptin e Ri Strategjik, i cili përcaktoi detyrat themelore të NATO-s dhe prioritetet për dekadën e ardhshme. Samiti i Çikagos i vitit 2012 lançoi Iniciativën e Mbrojtjes së Zgjuar, e cila mundësoi aleatët e NATO-s të punojnë më ngushtë së bashku për të përdorur më mirë burimet e kufizuara për zhvillimin e aftësive të reja dhe miratoi Iniciativën e Forcave të Ndërlidhura për t'i mbajtur forcat e tyre më të lidhura përmes rritjes së trajnimeve dhe stërvitjeve edhe pas përfundimit së misionit të ISAF-it. Në vitin 2014, në dritën e veprimeve agresive të Rusisë ndaj Ukrainës dhe rritjes së paqëndrueshmërisë në Lindjen e Mesme, NATO forcoi mbrojtjen e saj kolektive. Në samitin e Uellsit, udhëheqësit e NATO-s miratuan një Plan Gatishmërie Veprimi për t'ju përgjigjur edhe më shpejt çdo kërcënimi si dhe ndërmorën hapa të mëtejshëm për të rritur bashkëpunimin me partnerët në mbarë botën.

> *Kryeministri i parë që u bë Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, u emërua nga udhëheqësit e Aleancës në samitin e Strasburg-Kehl, në vitin 2009, kur ai ishte kreu i Qeverisë së Danimarkës. Ai e mori detyrën më 1 gusht të vitit 2009. Gjatë qëndrimit të tij, Rasmussen mbikëqyri misione të njëkohshme dhe operacione në tre kontinente. Në vitin 2010, në samitin e Lisbonës, NATO miratoi Konceptin e Ri Strategjik, i cili përcaktoi detyrat themelore të NATO-s dhe prioritetet për dekadën e ardhshme.*

Anders Fogh Rasmussen mbikëqyri dorëzimin e përgjegjësive së sigurisë nga misioni i ISAF-it i udhëhequr nga NATO tek Forcat Afgane të Sigurisë. Në vitin 2011, ai drejtoi misionin e suksesshëm ushtarak të mandatuar nga Kombet e Bashkuara për të mbrojtur popullin e Libisë nga sulmet. Mandati i Rasmussen mbaroi pas 5 vjetësh dhe dy muajsh në krye të Aleancës. Ai u pasua më 1 tetor nga Jens Stoltenberg, ish-kryeministri i Norvegjisë.

Rasmussen përshëndet nënshkrimin e marrëveshjes së sigurisë me Afganistanin

"Unë mirëpres nënshkrimin e Marrëveshjes së Sigurisë Dypalëshe ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Afganistanit si dhe Marrëveshjes së Statusit të Forcave ndërmjet NATO-s dhe Afganistanit. Përfundimi i këtyre marrëveshjeve hap një kapitull të ri bashkëpunimi ndërmjet NATO-s, partnerëve tanë dhe Forcave të Sigurisë Kombëtare Afgane.

Ndërkohë që misioni i ISAF-it do të përfundojë në fund të këtij viti, Marrëveshja e Statusit së Forcave të NATO-s siguron bazën ligjore për misionin e trajnimit, këshillimit dhe ndihmës ndaj Forcave së Sigurisë Afgane. Nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve do të thotë se ky mision i ri i udhëhequr nga NATO, i quajtur Resolute Support (Mbështetja e Vendosur), mund të fillojë më 1 janar të vitit 2015, siç është planifikuar.

Për më tepër, ne mbetemi të angazhuar për të ndihmuar në financimin e Forcave Afgane të Sigurisë deri në vitin 2017, në mënyrë që të ndihmojmë Afganistanin që të forcojë edhe më tej institucionet e tij si dhe të zhvillojë më tej bashkëpunimin tonë politik dhe praktik me Afganistanin nëpërmjet Partneritetit tonë të Qëndrueshëm.

Unë përgëzoj ngrohtësisht presidentin Ashraf Ghani Ahmadzai dhe shefin ekzekutiv Abdullah Abdullah ndërkohë që ata marrin postet e tyre. Ata po e marrin detyrën në një moment shumë të rëndësishëm për Afganistanin. Ne do të vazhdojmë të qëndrojmë me ta dhe me popullin afgan për një Afganistan të sigurt, të qëndrueshëm e të begatë".

Mesazhi i Rasmussen për trupat e NATO-s

Për pesë vitet e fundit, ka qenë një nder i madh për mua të punoj së bashku me udhëheqësit e përkushtuar e të aftë ushtarakë si dhe udhëheqësit civilë nga 28 vendet anëtarë të NATO-s. Gjithashtu, ka qenë një privilegj i madh për mua t'i shërbej Aleancës tonë të madhe së bashku me ju, burrat dhe gratë e Forcave të Armatosura. Gjatë këtyre pesë viteve, unë kam parë përkushtimin, profesionalizmin dhe aftësinë tuaj. Ju keni ruajtur paqen në Kosovë, keni shpëtuar jetë në Libi dhe e keni udhëhequr Afganistanin drejt rrugës së drejtë të sigurisë së tij. Ju keni demonstruar fuqinë e Aleancës tonë, jo vetëm nëpërmjet aftësive të pashoq ushtarake, por edhe përmes përkushtimit ndaj detyrave dhe dhembshurisë tuaj ndaj njerëzve të cilët luftojnë të gjejnë paqen në mes të terrorizmit, piraterisë dhe autoritarizmit. Disa prej jush kanë pësuar lëndime, të dukshme dhe jo të dukshme e kanë humbur miq në rrjedhën e shërbimit tuaj. Nuk ka fjalë për të shëruar fjalë të tilla, por ne duhet të vazhdojmë të respektojmë këto sakrifica përmes vigjilencës së vazhdueshme dhe angazhimit të rreptë për sigurinë e kombeve tona dhe përmbushjen e detyrave që na presin. Ky ka qenë zotimi juaj. Ju dhe ata para jush, e kanë përmbushur atë me besnikëri. Për këtë dhe për të gjithë atë që ju bëni, ju falënderoj sinqerisht të gjithëve ju dhe ata që kanë shërbyer nën flamurin e NATO-s. NATO do të mbetet Aleanca më e fuqishme ushtarake që bota ka njohur ndonjëherë, sepse ne ndajmë besimin e përbashkët për lirinë dhe demokracinë e qëndrojmë së bashku për të ruajtur këto vlera. Unë jam i bindur se kontributet tuaja të domosdoshme lidhur me këtë do të sigurojnë aftësinë e NATO-s për të kapërcyer sfidat e sotme dhe ato të së ardhmes.

Me respekt,
Anders Fogh Rasmussen
Për trupat e NATO-s

Jens Stoltenberg merr detyrën si Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s



Jens Stoltenberg mori postin e tij si Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s më 1 tetor 2014. Ish kryeministri norvegjez u emërua nga 28 aleatët në muajin mars, për të pasuar Rasmussen si Sekretar i Përgjithshëm. Ai kryesoi takimin e tij të parë të Këshillit së Atlantikut të Veriut të mërkurën pas marrjes së postit të tij si Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s. "Unë mezi pres të filloj nga puna dhe është një nder i madh për mua që të jem Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s", tha z. Stoltenberg pas mbërritjes në selinë e NATO-s. Ai u prit nga zëvendëssekretari i Përgjithshëm, Alexander Vershbow, ambasadori gjerman Martin Erdmann, dekan i Këshillit dhe zëvendëskryetari i Komitetit Ushtarak, gjenerallejtënant Mark Schissler. Z. Stoltenberg dhe ambasadori Vershbow bënë homazhe në Memorialin e NATO-s për të rënët para hyrjes në seli. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, përcaktoi prioritetet e tij dhe shprehu angazhimin e tij për zbatimin e vendimeve së samitit të Uellsit për të përforcuar mbrojtjen kolektive, për të zgjeruar rrjetin e partneriteteve të NATO-s si dhe për të ruajtur një lidhje të fortë transatlantike në konferencën e tij të parë për shtyp. "Samiti vendosi një kurs të qartë. Vendimet e marra në Uells do të sigurojnë që NATO të jetë e gatshme për të përballuar të ardhmen. Pra, ndërkohë që unë marr këtë detyrë, këto janë tre prioritetet e mija: Të mbajmë NATO-n të fortë, të ruajmë stabilitetin në vendet fqinje duke punuar me partnerët si dhe ta mbajmë të fortë lidhjen ndërmjet Europës dhe Amerikës së Veriut", u shpreh Jens Stoltenberg. Ai ka qenë më parë kryeministër i Norvegjisë nga vitet 2000-2001 dhe nga vitet 2005-2013.

AWACS e fundit kthehen në shtëpi nga Afganistani

Pas 1.240 misionesh dhe 12.240 orë fluturimi të vona, flota e AWACS është më në fund në shtëpi. Më 25 shtator AWACS i fundit u kthye në bazën e tij në Geilenkirchen, Gjermani, nga Mazar-a-Sharif, Afganistan.

NATO ka përcaktuar se avionët AWACS nuk do të jenë të nevojshëm për misionin Resolute Support. Ndikimi i përgjithshëm për të ardhmen do të jetë minimal, ndërkohë që kontrolli i trafikut ajror për avionët ushtarakë mbi hapësirën ajrore të Afganistanit do të menaxhohet nga Qendra e Raportimit dhe Kontrollit (CRC) në Al Udeid Qatar, koordinuar me autoritetet përgjegjëse të trafikut ajror civil.

"Burrat dhe gratë që kanë kryer këtë mision të rëndësishëm që nga janari i vitit 2011, kanë sjellë një ndryshim të madh tek forcat tona në Afganistan. Ata kanë qenë "sytë e qiellit" për trupa të panumërta që janë mbështetur tek ta për informata kritike në mbështetjen e mijëra misioneve", tha komandanti Suprem i Forcave Aleate për Europën, gjenerali Philip M. Breedlove.

Në Afganistan, Forca e Kontrollit Ajror të NATO-s dhe Paralajmërimit të Hershëm (NAEW&CF), ka pasur rol unik dhe të vlefshëm për Aleancën me kryerjen e mbikëqyrjes ajrore, funksionet taktike së menaxhimit të betejave, të tilla si mbështetja dhe kontrolli i avionëve miqësorë të përfshirë në operacionet ofensive dhe të mbrojtjes ajrore, mbështetjes gjatë fluturimeve, parandalimin e betejave ajrore, kërkimet luftarake dhe shpëtimin, zbulimin si dhe transportin taktik ajror.

"Unë dua të përgëzoj të gjithë Komponentin E-3A të NATO-s për më shumë se 3 vjet operacione të qëndrueshme në Afganistan. Ju bëtë diçka të pa-imagjinuar nga ata që krijuan Komponentin E-3A rreth 35 vjet më parë, duke treguar se Komponenti E-3A mbetet një aftësi e gatshme, e besueshme dhe relevante për komandantët e NATO-s sot", u shpreh gjeneralmajor Andrew Mueller, komandant i Komponentit E-3A të NATO-s.

NATO dhe Japonia kryejnë stërvitjen e parë të përbashkët kundër piraterisë

NATO dhe Japonia zhvilluan një stërvitje të përbashkët kundër piraterisë në Gjirin e Adenit më 25 shtator për të testuar komunikimin dhe aftësitë taktike. Kjo ishte e para stërvitje e tillë e përbashkët mes dy flotave detare. "Duke sinkronizuar aktivitetet tona dhe duke shkëmbyer informacionin tonë, kemi një shans më të mirë për të siguruar ujërat në rajon dhe në këtë mënyrë ta mbajmë korsinë detare të qetë dhe të sigurt", tha kapiteni Aage Buur Jensen, komandanti i misionit të NATO-s kundër piraterisë, Operacioni Ocean Shield (Mburoja Oqeanike). Stërvitja përfshiu shkatërruesin japonez JS Takanami dhe fregata daneze HDMS Esbern Snare, aktualisht anije e misionit të NATO-s. Stërvitjes e së enjtes përfshinë një sërë detyrash si sigurimin e anijeve dhe procedurat e komunikimit. "Nuk ka dyshim se Forcat Detare të Vetëmbrojtjes Japoneze janë një aktor i rëndësishëm dhe shumë i aftë në rajon dhe unë pres zgjerimin e bashkëpunimit që NATO ka me Japoninë", tha kapiteni danez. Anijet e NATO-s kanë patrulluar ujërat e Bririt të Afrikës që nga viti 2009, si pjesë e përpjekjeve më të gjera ndërkombëtare për të goditur piratët somalezë, të cilët kanë kërcënuar lundrimin botëror. Operacioni i NATO-s, Ocean Shield, ashtu si Bashkimi Europian dhe misionet e tjera kundër piraterisë kanë ulur ndjeshëm sulmet në rajon. Megjithatë, piratët vazhdojnë të kenë qëllimin dhe kapacitetin për të sulmuar anijet. Japonia është një partnere e vlefshme e NATO-s. Në maj të vitit 2014, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s,

Anders Fogh Rasmussen dhe kryeministri i Japonisë, Shinzo Abe, nënshkruan një marrëveshje për dialog të mëtejshëm politik dhe bashkëpunim praktik ndërmjet NATO-s dhe Japonisë, duke përfshirë fushat kundër piraterisë, ndihmave në raste fatkeqësish si dhe ndihmës humanitare.

Alba Musaraj, burimi: NATO.int

Ndjekja dhe harmonizimi i prioriteteve, monitorimi i zbatimit të Dokumenteve Strategjike

Intervistë me kolonel Bardhyl Kollçaku, drejtor i Drejtorisë së Politikave Strategjike

Drejtoria e Politikave Strategjike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit Strategjik të Mbrojtjes, është një nga drejtoritë e rëndësishme që merret me hartimin e dokumentave kryesorë staregjikë. Direktiva e Mbrojtjes e vitit 2014, ka përcaktuar objektivat dhe prioritetet kryesore mbi të cilat hartohen programet dhe praktikat e zbatimit në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shabit të Përgjithshëm. I morrëm këtë intervistë Kolonel Bardhyl Kollçaku drejtorit të drejtorisë së Politikave Strategjike, për të mësuar diçka më tepër rreth këtyre dokumentave strategjikë për gazetën ushtria.

Kolonel, strukturat e Forcave të Armatosura, janë përfshirë në një reformë të thellë për të përmbushur detyrimin kushtetues, cilat janë drejtimet kryesore të punës, ku mbështetet drejtoria juaj?

Së pari, falënderoj Gazetën "USHTRIA" për mundësinë që më jep për të ndarë me lexuesin disa mendime dhe ide në lidhje me fushën që mbuloj. Së dyti, përfitoj nga rasti për të falënderuar Ministren e Mbrojtjes zj. Mimi Kodheli dhe Shefin e Shtabit te Përgjithshëm të FA, Gjeneralmajor Jeronim Bazo për besimin që treguan dhe vlerësimin duke më emëruar në këtë pozicion të rëndësishëm, disa javë më parë.

Para emërimit në këtë detyrë, kam mbajtur pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Koordinimit dhe Integrimit, në Divizionin e Bashkëpunimit Ushtarak, në Komandën Strategjike të Aleancës (SHAPE, në Mons, Belgjikë, duke prezantuar në mënyrë dinjitoze vendin tonë në Strukturat e Aleancës. Përvoja disa vjeçare e punës në strukturat e NATO-s, si dhe eksperiencat e mëparshme të punës në Shtabin e Përgjithshëm (J5) dhe Ministrinë e Mbrojtjes, të ndërthurura me kualifikimet e nevojshme në fushën e Planifikimit Strategjik mendoj se do të më ndihmojnë në përmbushjen me sukses të kësaj detyre të rëndësishme. Nga ana tjetër, në punën time ndjehem mire se kam gjetur një staf të kualifikuar dhe me eksperiencë si në drejtorinë ku unë drejtoj, ashtu dhe në drejtorinë e NATO/BE/MJ.

Tashme lexuesi është i njohur me reformën e gjithanshme dhe të thellë që po kryhet në FA dhe MM për përmbushjen me sukses të detyrimeve kushtetuese dhe ato në kuadrin e Aleancës. Analiza e këtyre arritjeve dhe identifikimi i problemeve dhe shqetësimeve është bërë në muajin korrik 2014 (analiza e 300 ditëve të para) dhe nuk po ndalem shumë në këtë pikë. Në këtë prononcim të shkurtër me gazetën tuaj do të ndalesha pak në drejtimet kryesore të punës në të ardhmen. Ashtu siç theksoi Ministrja e Mbrojtjes në udhërrëfyesin për 300 ditët e dyta të qeverisjes në fushën e mbrojtjes korrik 2014 maj 2015, "300 ditshi i dytë do të jetë akoma më ambicioz, duke pasur si synim kryesor konsolidimin e arritjeve të deritanishme dhe çuarjen përpara të reformave në fushën e mbrojtjes për arritjen e objektivave të programit të qeverisë në fushën e mbrojtjes".

Donim të dinim diçka më konkretisht, ju lutem mbi prioritetet e drejtorisë suaj, e sidomos mbi legjislacionin. Sa i nevojshëm është ai në kushtet konkrete?

Përmirësimi i vazhdueshëm i legjislacionit, rishikimi i dokumenteve kryesore në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, rritja e kapaciteteve operacionale të Forcave të Armatosura, transformimi e reformimi i tyre, si dhe pjesëmarrja në operacione e misione do të vazhdojnë të mbeten prioritetet kryesore në fushën e mbrojtjes edhe në periudhën afat-shkurtër.

Miratimi i ligjeve te rëndësishëm te autoriteteve dhe pushteteve te komandimit dhe te karrierës ne forcat e armatosura do te shoqërohen shume

> *Përvoja disa vjeçare e punës në strukturat e NATO-s, si dhe eksperiencat e mëparshme të punës në Shtabin e Përgjithshëm (J5) dhe Ministrinë e Mbrojtjes, të ndërthurura me kualifikimet e nevojshme në fushën e Planifikimit Strategjik mendoj se do të më ndihmojnë në përmbushjen me sukses të kësaj detyre të rëndësishme. Nga ana tjetër, në punën time ndjehem mire se kam gjetur një staf të kualifikuar dhe me eksperiencë si në drejtorinë ku unë drejtoj, ashtu dhe në drejtorinë e NATO/BE/MJ.*

Me strukturën e re të Ministrisë së Mbrojtjes, në Drejtorinë e Politikave Strategjike, është ngritur Sektori i Jetësimit të Prioriteteve. Misioni dhe detyrat kryesore të këtij sektori janë: ndjekja dhe harmonizimi i prioriteteve të Ministrisë së Mbrojtjes me ato të qeverisë; monitorimi i zbatimit të Dokumenteve strategjike dhe lehtësimi e ndihma në unifikimin e procedurave dhe formateve të raportimit.

shpejt me paketën e akteve nënligjore dhe administrative për te mundësuar zbatimin sa me te mire te tyre. Paketa ligjore do te jete akoma më e plote pas miratimit te një sërë ligjesh te tjera si ai "Për Disiplinën ne Forcat e Armatosura; "Për Policinë Ushtarake ne Forcat e Armatosura"; "Për Medaljet ne Forcat e Armatosura" dhe disa VKM-ve të rëndësishme si ai "Për Pagat e Ushtarakeve aktive ne FARSH", etj.

Ashtu siç e ceka pak më sipër, rishikimi i dokumenteve në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes do vazhdojë të jetë prioritet i Ministrisë së Mbrojtjes në periudhën afat-shkurtër. Kjo nevojë ka lindur kaherë dhe bëhet më e ngutshme pas miratimit të dokumentit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare (korrik 2014) dhe gjetjeve te Rishikimit te Rishikimit te Mbrojtjes (RSM 2012).

Rishikimi i Strategjisë Ushtarake, krahas dokumenteve të tjera, është një ndër dokumentet themelorë dhe i rëndësishëm i FA. Si po punohet për të?

Rishikimi i Strategjisë Ushtarake do të jenë fokusi i punës së drejtorisë që unë drejtoj në këtë periudhë. Ajo që vlen të theksohet në këtë proces është karakteri gjithëpërfshirës i strukturave brenda dhe jashtë MM/SHPFA dhe stafeve akademike të institucioneve arsimore dhe studimore të FARSH, agjencive qeveritare dhe joqeveritare dhe grupe të interesit jashtë strukturave të Forcave të Armatosura, në hartimin e këtij dokumenti. Shtabi i Përgjithshëm i FARSH ka bërë një punë tepër cilësore në thithjen e mendimeve të strukturave të vartësisë dhe koordinimin e gjithë përpjekjeve në hartimin e këtij dokumenti të rëndësishëm, i cili është në fazën e fundit të konsultimit në MM/SHP, përpara se t'u dërgohet institucioneve të tjera për mendime. Ndërkohë, ka filluar puna paraprake në MM/SHP për hartimin e Planit Afatgjatë të Zhvillimit të FARSH, i cili natyrshëm do të pasojë Strategjinë Ushtarake 2014 duke plotësuar "majën e piramidës" të dokumenteve kryesore strategjike. Ideja e drejtueseve të lartë civile dhe ushtarakë është që ky dokument të jetë konciz në përmbajtje duke vendosur piketat më të rëndësishme se ku do shkojnë dhe si do të duken Forcat e Armatosura në periudhën afat-gjatë, dhe të shoqërohet me plane të detajuar sipas fushave specifike (personeli, logjistika, arsimi/trajnimi e stërvitja, modernizimi, etj.)

Po për dokumentet e tjera strategjike jeni duke punuar?

Sigurisht. Tabloja e dokumenteve strategjike nuk do të ishte e plotë pa Direktivën Vjetore të Ministrit të Mbrojtjes. Në momentet që po flas, jemi duke grumbulluar, studiuar dhe analizuar realizimet, arritjet, gjetjet dhe problematikat e Direktivës 2014, në mënyrë që të evitohen përsëritjet, të mundësohet një koherencë dhe vijueshmëri e prioriteteve dhe drejtimeve kryesore të punës së strukturave të MM dhe SHPFA.

Rishikimi i Strategjisë Ushtarake do të jenë fokusi i punës së drejtorisë që unë drejtoj në këtë periudhë. Ajo që vlen të theksohet në këtë proces është karakteri gjithëpërfshirës i strukturave brenda dhe jashtë MM/SHPFA dhe stafeve akademike të institucioneve arsimore dhe studimore të FARSH, agjencive qeveritare dhe joqeveritare dhe grupe të interesit jashtë strukturave të Forcave të Armatosura, në hartimin e këtij dokumenti.

Siç e dimë Direktiva e Mbrojtjes është një dokument vjetor, si do të jetë këtë vit?

Ideja është të hartohet një dokument i shkurtër, programatik dhe vizionar duke i krijuar hapësirë dhe fleksibilitet (room for maneuver) strukturave në MM dhe SHP në hartimin e Programeve Vjetore të Punës dhe Udhëzimeve përkatëse.

Me strukturën e re të Ministrisë së Mbrojtjes, në Drejtorinë e Politikave Strategjike, është ngritur Sektori i Jetësimit të Prioriteteve. Misioni dhe detyrat kryesore të këtij sektori janë: ndjekja dhe harmonizimi i prioriteteve të Ministrisë së Mbrojtjes me ato të qeverisë; monitorimi i zbatimit të Dokumenteve strategjike dhe lehtësimi e ndihma në unifikimin e procedurave dhe formateve të raportimit.

Sigurisht puna juaj është e lidhur me struktura të tjera të MM e SHP…

Aktualisht, në bashkëpunim me strukturat e tjera në MM dhe SHP jemi në fazën e identifikimit dhe përcaktimit të pikave të kontaktit për Jetësimin e Prioriteteve, të cilat pasi të trajnohen nga ana jonë do të ndjekin e raportojnë periodikisht realizimin e zbatimin e prioriteteve të strukturave të tyre, pa cënuar zinxhirin e komandimit.

Siç e shikoni, detyrat dhe angazhimet që përmenda më sipër janë të shumta dhe të ngjeshura, por jam i bindur se duke u mbështetur në aftësitë e personelit, bashkëpunimin e ngushtë me strukturat e tjera në MM dhe SHP (veçanërisht J5), dhe në orientimet e udhëzimet e qarta të drejtuesve më të lartë të Ministrisë e Shtabit të Përgjithshëm do realizojmë në kohë e me cilësi të gjitha detyrat e ngarkuara.

Intervistoi: M. Golikja

Burimet e financimit në ekuacionin e të ardhurave të ISIS

MIMOZA GOLIKJA

Një numër i madh xhihadistësh të shtetit Islamik Isis, lëvizën në këtë fund muaj drejt zonës kufitare turke, rreth 60 kilometra në veri të Aleppos, me kolonat e kamionëve të blinduar, të grabitur nga repartet ushtarake të braktisura, të Irakut. Ekstremistët islamikë gjithmonë kanë kërkuar të sigurojnë kufirin midis Turqisë dhe Sirisë veri perëndimore, si portë kryesore për rekrutët për tu bashkuar me kalifatin. Kjo zonë është tani një nga linjat më aktive të frontit në përpjekjet e grupit për të ri vizatuar kufijtë e Levantit, një fushatë kjo që do të ketë pasoja të mëdha për Turqinë. Qeveritë evropiane dhe SHBA pothuaj 18 muajt e fundit, i kanë bërë thirrje Turqisë, vend anëtar i NATO-s, për të bërë më shumë për të ndaluar xhihadistët që kalojnë në Siri. Zyrtarët e Ankarasë kanë thënë se e kanë pasur të vështirë për të dalluar mes pelegrinëve fetarë që udhëtojnë në Turqi dhe atyre që synojnë të bashkohen me xhihadin, madje zyrtarët e inteligjencës turke, kanë këmbëngulur nga ana tjetër se janë vendet ato që duhet të japin alarmin, nga të cilat nisen qytetarët e tyre që mund të jenë ekstremistë. Gjithmonë është nënvizuar mbi thellimin e ndjeshmërisë përreth rritjes së shpejtë të kërcënimit ekstremist rajonal në figurat e larta të Lindjes së Mesme dhe Evropës duke përfshirë edhe Turqinë, për të cilën ka pasur zëra kritikë se ka lehtësuar ose nëpërmjet "neglizhencës" apo "politikave të pashpallura", lejimin e përdorimit të korridoreve të saj. Madje burimet thonë se që nga maji i vitit 2012, kufiri turk ka lejuar armë dhe furnizime të destinuara për të kaluar në grupet e njohura të opozitës siriane. Shitja e naftës dhe e mallrave të tjera përmes rrjeteve të brezave të vjetër të kontrabandës është bërë nën "hundën" e qeverisë rajonale kurde në veri të Irakut, si dhe të autoriteteve në Turqi dhe Jordani, sipas burimeve. Vitin e kaluar, Shteti Islamik filloi ofensivën e gjerë në zonat e pasura me naftë në Sirinë lindore dhe ishte në gjendje për të fituar kontrollin e pothuajse të gjitha fushave të mëdha të naftës, duke përfshirë fushën e naftës Omar, më e madhe në Siri, me një kapacitet për të prodhuar 75.000 fuçi naftë në ditë. Në anën irakiane të kufirit, grupi kontrollon fushat e vogla në krahinën qendrore të Salahudin dhe krahinën lindore Diyala, duke përfshirë fushat e Ajeel dhe Himrin. Militantët shesin vajin e kontrabanduar në zbritje të çmimeve nga 60 $ në 20 $ për një fuçi nafte që normalisht shitet më shumë se 100 $, por fitimet e tyre totale nga nafta tejkalojnë 3.000.000 $ në ditë, sipas ekspertëve. E ndërsa në Irak,



Isis i ka kapur fushat e naftës që pas ofensivës së qershorit, kur morri pjesë të mëdha të rajoneve veriore, qendrore dhe perëndimore të vendit, në Siri nga ana tjetër, rebelët kanë konfiskuar fusha që nga fundi i vitit 2012, një vit pas fillimit të krizës së vendit. Gjatë vitit të kaluar, grupi i Shteti Islamik ka marrë kontrollin e fushave të mëdha të naftës të vendit. Para fillimit të kryengritjes kundër qeverisë së presidentit sirian Bashar Asad në mars 2011, sektori i naftës ishte një shtyllë e ekonomisë së Sirisë dhe vendi prodhonte rreth 380.000 fuçi në ditë, që eksportohej kryesisht në Evropë me një shifër në më shumë se 3 miliard dollarë p.sh në vitin 2010. Oil siguronte rreth një të katërtën e të ardhurave të fondeve për buxhetin e qeverisë. Isis ndoshta nuk është mbështetur në mbrojtës të huaj për të ndërtuar kapacitetin e tij sepse ai ka kryer grabitje të armëve, ndërmarrjeve shtetërore dhe të bankave. Por megjithatë, Isis ka shitur naftë nga fushat që ai kontrollon në Sirinë lindore edhe për turqit edhe për lidhjet e regjimit në Damask. Por Turqia tashmë ka kthyer në shtëpitë e tyre 49 pengjet e saj të mbajtura nga Isis, që në fillimet e sulmit mbi Mosul dhe ajo nuk "i ka më duart e lidhura", madje ajo i është përgjigjur thirrjes së SHBA dhe aleatëve kundër grupit terrorist. Isis vazhdon të alarmojë rajonin me kapacitetin e tij për të luftuar në disa fronte, një tipar që u shfaq së fundmi në Siri, ku paraprakisht në veri u përpoq për të kapur bazën ajrore të fundit të mbetur në regjimin e Sirisë lindore, përveç kapjes të shumicës së fushave më të mëdha të naftës të Sirisë, që besohet se ndikon në rritjen e fondeve të luftimeve me shitjen e naftës në tregun e zi. E ndërsa besohet se Isis kontrollon më se 12 fusha të naftës në Irak dhe Siri, që kontribuojnë në të ardhurat prej më shumë se 3 milion $ (£ 1.85) në ditë në kontrabandën e naftës dhe të aktiviteteve të tjera, ndërkohë mbështetja e grupit terrorist nga nafta si burim kryesor i të ardhurave, mund të jetë ndërprerë, nga sulmet ajrore të koalicionit të udhëhequra nga SHBA. Sulmet ajrore të udhëhequra nga SHBA, sipas burimeve të Reuters, kanë në shënjestër edhe rafineritë e naftës të kontrolluara nga Isis. Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, janë bashkuar në këto sulme mbi objektet e pilotuara.

Sulmet ajrore mbi fushat e naftës të kontrolluara nga Isis, goditja e rafinerive të naftës

Sulmet ajrore të SHBA dhe aleatëve arabë të filluara ditët e fundit dhe të pasuara edhe nga mbështetja e gjerë e vendeve evropiane, shënjestruan edhe infrastrukturën e naftës të shtetit islamik, Isis. Bazat dhe fushat e naftës të Isis në krahinën siriane lindore të Deir el-žOur u goditën në fluturime gjatë natës në sulmet e kryera nga forcat e udhëhequra nga SHBA e Britania e Madhe, sipas raportimeve të grupit monitorues, pjesë e Observatorit me bazë siriane për të Drejtat e Njeriut, e cila monitoron konfliktin nëpërmjet rrjetit të burimeve. Bombardimet kundër militantëve të Isis në veri dhe lindje të Sirisë, filluan nga ana e SHBA-së mbi bazat e fraksionit të al-Kaidës në Irak, që prej muajit të kaluar. Sulmi goditi zonën al-Quriyah dhe Deir el-žOur. Deir el-žOur, që kufizohet me Irakun dhe krahinë e madhe e prodhimit të naftës nga ku filloi konflikti i parë i Sirisë, më shumë se tre vjet më parë, është pothuajse tërësisht i kontrolluar nga militantët Isis. Oil ka qenë një burim i lartë i të ardhurave për militantët e Isis dhe sulmet ajrore të ditëve të fundit kishin në shënjestër rafineritë e kontrolluara nga grupi. Sulmet tregojnë gjithashtu, se kanë për qëllim të pengojnë aftësinë e Isis për të vepruar përtej kufirit në Irak, ku ai kontrollon territorin, si dhe t'i ndërpresin atij furnizimin e financimit të militantëve të tij. Natën e tretë, sipas grupit të vëzhguesve, objektivat e sulmeve ajrore amerikane kundër Isis brenda Sirisë, fokusuan infrastrukturën e naftës të kontrolluar nga grupi militant, në një përpjekje të dukshme për të prerë furnizimin e tij të financimit. Përveç sulmeve të raportuara ndaj një serie të instalimeve të naftës rreth qytetit të Mayadeen, në provincën lindore të Deir el-žOur, u tha nga Observatori Britanik me bazë siriane për të Drejtat e Njeriut dhe grupet lokale të aktivistëve, se pati 19 të vrarë, midis të cilëve edhe 5 civilë. Sulmet e tjera goditën postblloqe dhe automjete të Isis që mbanin territorin në veri dhe në lindje të Sirisë dhe përgjatë kufijve të Turqisë dhe Irakut. SHBA ka zhvilluar sulme ajrore kundër objektivave të Isis brenda Irakut për më shumë se një muaj. Në deklaratën e saj të sulmeve të para, Komanda Qendrore Amerikane kur raportoi, tha se ka qenë një total prej 13 sulmesh kundër 12 rafinerive modulare të naftës të kontrolluara nga Isis. "Ne po vlerësojmë rezultatin e sulmit në rafineritë, por indikacionet fillestare janë se sulmet ishin të suksesshme", sipas Komandës Qendrore. Rafineritë modulare janë të parafabrikuara dhe të ndërtuar me faqe të mbyllura në mënyrë që ato mund të transportohen dhe të bëhen shpejt operacionale. Sipas raportimeve të Ushtrisë amerikane rafineritë ishin të afta për të prodhuar miliona të ardhura dhe për të siguruar karburant për operacionet e grupit. "Këto rafineri të shkallës së vogël ofronin karburant për Isil për të drejtuar operacionet, paratë për të financuar sulmet e tyre të vazhdueshme në të gjithë Irakun dhe Sirinë, dhe një vlerë ekonomike për të mbështetur operacionet e tyre në të ardhmen" thuhet në raportim. Është e paqartë se sa është nafta e papërpunuar ose vaji i rafinuar që ISIL menaxhon për të shitur. Madje ka edhe raportime se Isis ka prodhuar pak më pak se 100.000 fuçi naftë bruto në ditë, për shembull, sipas kreut të Administratës së Informacionit të Energjisë. Nga ana tjetër përfaqësuesi i Qendrës Kombëtare Kundër terrorizimit, dëshmoi në Kongresin amerikan këtë muaj "se shuma e të ardhurave të luftës e Isil ndoshta përfshinte rreth 1ma $ në ditë" nga shitjet në tregun e zi e naftës, kontrabandës, grabitjeve si dhe pagesave për çmimet për shpengimin e pengjeve.

Përpjekje për shkatërrimin e rrjeteve të financimit të Isil

Sulmet e SHBA dhe aleatëve mbi Isis janë një luftë për të goditur rrjetin e gjerë të shitjes në tregun e zi, si dhe miliona dollarë të ardhura të naftës të përfituara prej Isis në Irak dhe Siri, i cili është gjithashtu edhe një nga grupet terroriste më të pasura në histori. Burimet perëndimore të zbulimit thonë se shuma e dërgesave dhe parave të pista të naftës të Isis, lëviz nëpër Irak dhe në rajonet jugore kufitare të Turqisë dhe pavarësisht diskutimeve të gjera brenda Pentagonit, forcat amerikane deri më tani nuk kanë sulmuar kamionët cisternë, edhe pse sipas burimeve thuhet "se mbetet një opsion". Qasja e ISIS "në drejtim të të ardhurave" është kritike sidomos për aftësinë që ka për të rekrutuar anëtarë, në plotësimin e listës së pagave në rritje të luftëtarëve, për të zgjeruar ndikimin dhe veprimin në të gjithë territorin e të dy vendeve. Madje ndalimi i rrjedhjes së luftëtarëve të huaj, siguria e kufijve dhe shkatërrimi i rrjeteve të financimit të Isis janë aspekte të rëndësishme të strategjisë, "ne do të vazhdojmë të punojmë ngushtë me partnerët tanë në rajon në këto përpjekje në ditët që vijnë," thonë zyrtarët e Pentagonit. Në thelb të bisedimeve janë një numër i fushave që shkon nga dymbëdhjetë e më shumë të naftës dhe të rafinerive në Irak dhe Siri në territorin ku Isis ka kontrollin. Prodhimi ka qenë një rrjedhje e qëndrueshme e financimit, për të cilën ekspertët thonë se "1 mil-

ion dollarë madje edhe në 2 milion $ në ditë, është një lëmoshë në drejtim të tregut global të naftës, por një fat dhe një e papritur e madhe për një grup terrorist". Oil është një tregues i rëndësishëm i ekuacionit të financimit që fuqizon Isis, vlerësohet nga Fondacioni Heritage për çështjet e Lindjes së Mesme, qendër kërkimore me bazë në Uashington. Sipas burimeve, territori që Isis kontrollon vetëm në Irak, prodhon aktualisht një shifër që shkon diku nga 25.000 deri në më shumë se 40.000 fuçi naftë në ditë, të cilat mund të marrin një minimum të ardhurash prej 1.200.000 $ në tregun e zi, sipas, Brookings Doha Center, Institut i Energjisë në Irak. Disa vlerësime edhe pse zyrtarët amerikanë janë skeptikë nga ajo që është vendosur, thonë se të ardhurat ditore që rrjedhin për Isis nga shitja e naftës janë nganjëherë më larta edhe se në 2 milion $. Sipas burimeve "hyrja kyçe nëpër tregun e zi është korridori jugor i Turqisë," madje është shkuar deri atje sa ka pasur zëra se Turqia po bëhet pjesë "e kësaj ekonomie të zezë" që financon Isis. Marrja me rrjetin e kontrabandës ka provuar një sfidë të madhe, pasi përfitimet nga çmimi më i ulët i kontrabanduar i naftës në tregun e zi, ka bërë përfitues një numër të konsiderueshëm mbase edhe të turqve. Zinxhiri i furnizimit të rrugëve, individët, familjet dhe organizatat që lejojnë naftën të rrjedhë, janë të mirë krijuara dhe disa prej tyre datojnë në dekada, që nga koha e Sadam Huseinit të Irakut, pasi "këta kufij nuk kanë qenë të mbyllur", vlerësojnë burimet. Irani gjithashtu ka përdorur mjaft mjete konvencionale për të arritur tregjet e naftës dhe një nga teknikat që zbatohet për shitjet e Isis është tregu i zi, zhvilluar kryesisht përmes rrjeteve të kontrabandistëve. Plani afatgjatë amerikan sot është i përqendruar për të goditur rrjetet e kontrabandës. Është thënë shpesh se disa nga rrjetet e kontrabandës kanë ndihmuar që të "përfitojë një elitë e fuqishme turke", që synon në perfeksionim të mëtejshëm të kthimit të naftës bruto apo produktet petrokimie. Por mbledhja e inteligjencës është një proces i ngadalshëm, thonë analistët. Madje "është e vështirë për të përdorur atë çka është në dispozicion të Departamentit Amerikan të Thesarit për të dënuar njerëz në këtë rast", citohet nga mediet p.sh të ketë thënë Patrick B. Johnston, studiues i RAND Corporation i cili po punon për një studim lidhur me "financimin dhe organizimin" e Isis. Kjo është e vërtetë edhe për burimit të tjera të mëdha të parave të Isis, nga aktivitetet e tij të grabitjeve në zonat që kontrollon, sipas studiuesit, i cili po shqyrton dokumentet e deklasifikuara dhe detajet e rrjedhjes së financimit të grupit. Po kështu është edhe përqindja nga 10 deri 20 e të ardhurave të tjera nga bizneset në territoret ku vepron Isis, në një gjysmë fushe "mafia-style" që jep më shumë se sa 1 milion dollarë në ditë.

Etja e pakontrolluar për naftë, një katastrofë globale"
Mjedisi dhe debati i energjisë

Etja mizore dhe e dhunshme e Shtetit Islamik për jetë njerëzore ka shokuar botën, por etja tjetër e zjarrtë e Isis në mënyrë konstante dhe e pashuar, është etja për naftë që mund të jetë një "katastrofë" për ekonominë globale, në qoftë se kjo organizatë terroriste nuk ndalohet. Grupi xhihadist, i njohur më parë si Isis, që tani kontrollon disa fusha të naftës si dhe rafineri në veri të Irakut, e ka çuar në më shumë se 2.000.000 $ në ditë fitimin kur ka shitur deri në 40.000 fuçi nëpërmjet ndërmjetësve në marrëveshje të paligjshme, sipas ekspertëve. Vaji i Tregut të zi shitet rreth 25 $ deri 60 $ për fuçi, krahasuar me normën aktuale të tregut prej 100-102 $, sipas burimve të Institutit të Energjisë në Irak. Ndërkohë që kjo është një rënie e vërtetë globale e prodhimit të naftës së papërpunuar, që sipas ekspertëve nëse kjo nuk do të ndalohet, nga ana tjetër do të vazhdojë të përkthehet në fondet terroriste për militantët e Isis. Nëse nuk bllokohen "hyrjet e të ardhurave të organizatës së terrorit dhe zonat nga këto të ardhura vijnë", ato do të vazhdojnë të rriten dhe sipas raportimeve edhe pse "qeveria e Irakut ka njoftuar tani, dihet se kjo gjë ka vazhduar për muaj me radhë". Kohët e fundit ministria irakiane e Naftës paralajmëroi blerësit e naftës së papërpunuar, për blerjet e paautorizuar të bëra në vend që mund të përdoreshin për të financuar aktivitetet terroriste nga shteti islam, si dhe bëri thirrje që të "ushtrojnë kujdes" duke iu kujtuar se çdo blerje pa autorizim mund të rezultojë në sanksione për veprimtari terroriste financiare. Sipas raportimeve të ekspertëve thuhet se fushat e naftës dhe rafineritë e kontrolluara nga Isis në Irakun e Veriut mund të prodhojnë potencialisht më shumë se 80.000 fuçi naftë në ditë, por aktualisht rreth gjysma e naftës është konfiskuar direkt nga tanket dhe tubacionet, (krahasuar me Irakun jugor që prodhon më shumë se 3 milion fuçi në ditë, Texasin rreth 2.5 milion, kurse Alabama dhe Misisipi prodhojnë rreth 28.000 dhe 66.000 fuçi respektivisht çdo ditë, ndërkohë që Turqia, prodhon rreth 46.000 fuçi të përditshme, sipas vlerësimeve). Sipas analistëve një nga qëllimet e deklaruara të militantëve të shtet islamik, është për të marrë në gadishullin arabik, sasi të mëdha të burimeve natyrore të fushës të energjisë dhe nëse kjo do të arrihej do të mund të sillte ndryshime në mënyrë drastike në peizazhin e rajonit. Por edhe nëse kjo vazhdon, si tashmë, "mund të çekuilibrojë në mënyrë të konsiderueshme disa nga burimet rajonale të energjisë", thonë ekspertët. Madje ideja se Isis mund të ketë kontakte të fushave në jug, e cila sipas burimeve ende nuk ka ndodhur, është e mjaftueshme për të qenë kërcënim, gjë që do të mund të destabilizonte më thellë të gjithë rajonin. Isis i shet naftën e Irakut tregtarëve kurdë në rajonet në kufi me Irakun, Iranin dhe Sirinë para se ta dërgojë atë në Pakistan, ku sipas burimeve po shitet për më pak se gjysma e normave të tregut, duke kontrolluar rreth 60 për qind të prodhimit të fushave të Sirisë në rajonet lindore të pasura me naftë. Por analistët venë në dukje se përveç naftës, të ardhurat e Isis vijnë edhe nga operacionet e tij të shpeshta të paligjshme si grabitjet, rrëmbimet për shpërblim, si dhe duke shitur një numër të madh të antikave të grabitura në veri të Irakut. Sado e parëndësishme të duket kjo "u jep atyre mbështetje të konsiderueshme financiare". Numri i Isis në më shumë se 25.000 luftëtarë, ku gati gjysma e të cilëve janë të huaj, jashtë Irakut apo Sirisë kanë ndoshta synimin drejt territoreve të pasura të naftës të Libisë dhe Gadishullit Arabik e veçanërisht të Arabisë Saudite, gjë që do ta çonte prodhimin në një "katastrofë globale", pasi rajoni prodhon 40 për qind të energjisë globale dhe ku aktualisht 60 për qind e naftës konvencionale dhe gazit mbahet peng prej terroristëve. Madje sipas burimeve pretendohet se militantët kanë kontrabanduar naftën siriane në Turqi me vlerë rreth 800 milion dollarë. Me të ardhurat e naftës dhe armëve organizata e grupit xhihadist që kontrollon një territor të madh të Sirisë dhe Irakut, aspiron shtetësinë, me zgjerimin gjeografik dhe të dhunshëm, si dhe praktikat e Isil që paraqesin një sfidë kolosale të sigurisë të rajonit.

Grupi xhihadist i Isis që përdor mediet sociale, videot madje edhe filma të një metrazhi pothuaj të gjatë për të trembur, rekrutuar ndjekës të rinj dhe për të përhapur mesazhin e tij, është një sfidë globale. Kjo sfidë tashmë jo vetëm për imazhet e gjakosura, videot dhe propagandën e frikshme të një force të shfrenuar dhe të pandalshme. Postimi i imazheve të masakrave gjakftohta, kokat e prera në mbulimet e gjera medietike, sofistikimi, pasuria dhe fuqia ushtarake e grupit të Shtetit Islamik paraqet një kërcënim serioz për botën. "Ata janë një kërcënim i pashmangshëm, jo vetëm në Irak apo kudo tjetër," ka thënë Sekretari i Mbrojtjes Chuck Hagel gazetarëve në Pentagon, "përtej vetëm se sa një grup terrorist, i ideologjisë, sofistikimit, nivelit ushtarak, si dhe financimit. Kjo është përtej çdo gjëje që ne kemi parë", ky është një citim i Sekretarit të mbrojtjes i SHBA Chuck Hagel, pas postimit të videos nga grupi terrorist në mediet sociale që tregonte një prej luftëtarëve të tij teksa i priste kokën gazetarit amerikan, që ishte rrëmbyer në Siri.

Por konflikti në Lindjen e Mesme është një kërcënim i madh për jetën njerëzore dhe më gjerë dhe jo vetëm në rajon, është edhe për ekonominë dhe sigurinë e energjisë në tregjet e naftës botërore, duke ravijëzuar pasiguri nëpërmjet çmimeve të vendosura sipas kushteve të tregut të zi. Disa nga dinamikat më të rëndësishme që ndikojnë në tregjet e naftës, që ndodhin në Lindjen e Mesme vitet e fundit kanë qenë të jashtëzakonshme. Ky nuk është vetëm burimi gjithnjë e më i ndryshëm i konfliktit rajonal dhe i brendshëm në zonë, si dhe numri në rritje i prodhuesve të naftës dhe gazit të Lindjes së Mesme, që sot shënojnë një numër të paparë, por edhe se si tregjet e naftës i janë përgjigjur konfliktit. Humbjet nga Libia dhe nga Irani nën sanksionet e intensifikuara që nga mesi i vitit 2012 deri më tani, përbënin pjesën më të madhe të ndërprerjeve të furnizimit nga rajoni gjatë dy viteve të fundit, me humbjet më të vogla shtesë nga Iraku, Jemeni, Sudani dhe Siria të shkatërruara nga lufta. Tregjet e naftës kanë provuar të tregojnë se janë jashtëzakonisht elastike. Pikëpamjet apo perspektivat globale të furnizimit, sipas ekspertëve, mbeten shumë optimiste në aftësinë e SHBA për të dhënë gjatë dekadës së ardhshme, e cila duket si një rritje historike e furnizimit për më shumë vite që do të vijnë. Por ata vlerësojnë se mbase "shqetësuese për këto parashikime optimiste, janë rrjedhoja dhe vendimet e investimeve të bëra nga prodhuesit e energjisë alternative". Vendimet mbi ku dhe si do të investohet nga aktorë shumë të rëndësishëm të tregut të naftës p.sh si Arabia Saudite dhe prodhues të mesëm të tillë si Kuvajti dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, që janë tregues të rëndësishme të çmimeve të naftës nesër. Këto vende tashmë po përballen me pasiguri nga brenda rajonit të tyre, që në fund të fundit, "ende nuk dihet se sa është sasia e naftës që mund të pritet për tu eksportuar nga Libia, Irani apo Iraku". Prandaj sipas ekspertëve është e rëndësishme ajo që diskutohet sot në mjedisin e energjisë që sot ndoshta duket vetëm te çmimet e naftës, të cilat do të ndikojnë në këtë fushë jo vetëm nesër, por për javët dhe vitet që vijnë më pas. Kjo do të thotë çmime më të larta të energjisë në Mbretërinë e Bashkuar, në Evropë dhe në tregjet e tjera të konsumit perëndimor që s'do të bënin gjë tjetër vetëm se do të çonin në kosto më të larta të jetesës, norma më të larta të inflacionit, si dhe një shterim të mundshëm ndoshta në degë të rëndësishme të ekonomisë, vlerësojnë ekspertë të studimeve të energjisë dhe departamenteve të studimeve financiare dhe të menaxhimit.

Rritja e kërcënimeve kompjuterike

11 Shtatori 2001 është quajtur shpesh dita që ndryshoi gjithçka. Kjo mund të mos jetë e përpiktë për jetën tonë të përditshme, por në fushën e sigurisë, ajo shënoi me të vërtetë një epokë të re. Së bashku me Kullat Binjake, u shembën edhe perceptimet tona tradicionale për kërcënimet. Skenari i Luftës së Ftohtë, që kishte mbizotëruar për më shumë se 50 vjet, ishte ndryshuar rrënjësisht dhe pakthyeshmërisht.

Kërcënimi nuk ka më një adresë të qartë (kombëtare) të dërguesit. Kufijtë territorialë janë bërë të pakuptimtë, ashtu si edhe militarizimi i hapësirës dhe i kohës. Përdorimi i aeroplanëve civilë si mjete për një sulm terrorist, tregoi se pothuajse çdo gjë mund të shndërrohet në një armë, në çdo kohë. Papritmas asgjë më nuk duket të jetë e pamundur ose e papërfytyrueshme. Ky përshkrim është pothuajse i njëjtë edhe për kërcënimet kompjuterike. Gjatë 20 viteve të fundit, teknologjia e informacionit është zhvilluar së tepërmi. Nga një mjet administrativ për të ndihmuar në përsosjen e proceseve zyrtare, tashmë është një instrument strategjik i industrisë, i administratës dhe i ushtrisë. Para 11 Shtatorit, rreziqet e hapësirës kompjuterike dhe sfidat e sigurisë diskutoheshin vetëm brenda grupeve të vogla të ekspertëve teknikë. Por, që nga ajo ditë, u bë e qartë se bota e kompjuterave shkakton pasoja të rënda për shoqëritë me varësi të ndërsjellë gjithnjë në rritje.

Rritja e kërcënimit kompjuterik

Rrjeti mbarëbotëror i internetit, i shpikur vetëm disa dhjetëvjeçarë më parë, është zgjeruar. Por, po ashtu, edhe kërcënimet ndaj tij. Shqetësimet e vogla të shkaktuara nga krimbat dhe viruset janë shndërruar në sfida të mëdha të sigurisë dhe në instrumente të përsosura të spiunazhit kompjuterik. Sulmet ndaj një objektivi për shmangien e shërbyesit kompjuterik, deri më tani të vështruara kryesisht si jo më shumë se "bllokime të plogëta" të të dhënave hyrëse në linjë, janë bërë një mjet në luftën informative. Dhe së fundi, në qershor 2010, programi tinëzak "Stuxnet" u bë i njohur, pak a shumë, si një "bombë kompjuterike betonshpuese" me goditjen ndaj programit bërthamor iranian. Me këtë janë bërë realitet paralajmërimet e hershme të ekspertëve qysh më 2001, duke sugjeruar se përmasa kompjuterike, herët a vonë, do të mund të përdorej për sulme të rënda me pasoja vdekjeprurëse në botën fizike. Një valë sulmesh masive trijavore ndaj rrjetit kompjuterik, tregoi se shoqëritë anëtare të NATO-s, tejet të varura nga komunikimi elektronik, ishin gjithashtu shumë të cenueshme në frontin kompjuterik.Gjatë krizës në Kosovë, NATO u përball me incidentet e saj të para të rënda të sulmeve kompjuterike. Kjo çoi, midis të tjerash, në bllokimin disaditor të llogarisë së postës elektronike të Aleancës për vizitorët e jashtëm dhe në ndërprerje të përsëritura të faqes së internetit të NATO-s. Megjithatë, tipike për atë kohë ishte se përmasa kompjuterike e konfliktit vështrohej thjesht si pengesë për fushatën informative të NATO-s. Sulmet kompjuterike vështroheshin si një rrezik, por i kufizuar në mundësinë e shtrirjes dhe të dëmtueshmërisë, për të cilat kërkoheshin vetëm kundërveprime të kufizuara teknike, të shoqëruara me përpjekje të një shkalle të ulët të informimit të publikut. U deshën ngjarjet e 11 Shtatorit për të ndryshuar atë perceptim. Dhe madje ishin të nevojshme incidentet në Estoni në verën e vitit 2007 për të përqendruar më në fund vëmendjen e plotë politike për këtë burim në rritje të kërcënimeve ndaj sigurisë publike dhe stabilitetit shtetëror. Një valë sulmesh masive trijavore ndaj rrjetit kompjuterik, tregoi se shoqëritë anëtare të NATO-s, tejet të varura nga komunikimi elektronik, ishin gjithashtu shumë të cenueshme në frontin kompjuterik. Vetëdijesimi në rritje për seriozitetin e kërcënimit kompjuterik u përforcua edhe më shumë nga incidentet në vitet e ardhshme. Më 2008, një nga sulmet më të rënda deri më sot, u krye kundër sistemeve kompjuterike ushtarake amerikane. Nëpërmjet një çelësi të thjeshtë USB, të lidhur në një kompjutër prehëri me pronësi ushtarake në një bazë ushtarake në Lindjen e Mesme, programi spiun depërtoi pa u zbuluar në dy sisteme njëherazi, në atë të sekretuar dhe në të pasekretuar. Kjo krijoi atë çka mund të quhet një kryeurë e shifruar, nga e cila u zhvendosën mijëra skedarë të dhënash drejt shërbimeve kompjuterike nën kontrollin e huaj. Që atëherë, spiunazhi kompjuterik është bërë një kërcënim pothuajse i vijueshëm. Incidente të ngjashme kanë ndodhur pothuajse në të gjitha shtetet e NATO-s dhe – mjaft më dukshëm – kohët e fundit përsëri në Shtetet e Bashkuara. Këtë herë u prekën më shumë se 72 shoqëri , përfshirë 22 zyra qeveritare dhe 13 kontraktues të mbrojtjes. Këto incidente të shumta gjatë pesë apo gjashtë viteve të fundit kanë çuar në një zhvendosje, historikisht të pashembullt të pasurisë dhe të sekreteve kombëtare të ruajtura me kujdes, drejt duarve krejt anonime dhe me shumë gjasë të liga. "Stuxnet-i" tregoi rrezikun e mundshëm të programeve tinëzake në cenimin e sistemeve kompjuterike të rëndësisë së veçantë që administrojnë furnizimin me energji.Gjatë konfliktit Gjeorgji-Rusi u kryen sulme masive mbi faqet e internetit të qeverisë dhe të shërbimeve kompjuterike në Gjeorgji, duke i dhënë një formë më konkrete termit të luftës kompjuterike. Këto veprime nuk kanë shkaktuar dëme fizike. Por sidoqoftë, ato dobësuan qeverinë gjeorgjiane gjatë një faze të vështirë të konfliktit. Ato gjithashtu ndikuan në aftësinë e saj për të komunikuar me një publik kombëtar dhe ndërkombëtar tejet të tronditur. Sikur të mos mjaftonte ana kërcënuese e të këtilla raporteve, krimbi "Stuxnet" që u shfaq më 2010 nxori në pah një kapërcim të vogël cilësor të mëtejshëm në aftësitë shkatërruese të luftës kompjuterike. Në verën e vitit 2010, u përhap lajmi se rreth 45.000 sisteme kontrolli të punës të "Siemens-it" në të gjithë botën ishin infektuar nga një virus trojan i përshtatur, që mund të manipulonte proceset teknike me rëndësi të veçantë për centralet bërthamore në Iran. Edhe pse vlerësimi i dëmeve mbetet ende i paqartë, kjo tregoi rrezikun e mundshëm të programeve tinëzake në cenimin e sistemeve kompjuterike të rëndësisë së veçantë që administrojnë furnizimin me energji apo rrjetet e trafikut. Për herë të parë, këtu u dha prova se sulmet kompjuterike përmbajnë në vetvete mundësinë për të shkaktuar dëme të njëmendta fizike dhe për të rrezikuar jetën e njerëzve.

Një vlerësim i drejtpeshuar i kërcënimeve

Këto incidente qartësojnë dy gjëra: 1)Deri më tani, aktorët më të rrezikshëm në domenin kompjuterik janë shtetet-kombe. Pavarësisht nga një prani në rritje e aftësive sulmuese në rrjetet kriminale, që mund të përdoren në të ardhmen edhe nga aktorë joshtetërorë si terroristët, spiunazhi dhe sabotimi tepër i stërholluar në domenin kompjuterik ka nevojë ende për aftësitë, vendosmërinë dhe analizën e kostos përfituese të një shteti-komb. 2) Dëmtimi i pronës dhe terrorizmi kompjuterik i vërtetë kinetik nuk është hasur ende. Por teknologjia e sulmeve kompjuterike është duke u përshkallëzuar dukshëm nga një shqetësim i vogël në një kërcënim të madh kundër sigurisë së informacionit e madje, edhe të infrastrukturës kombëtare të rëndësisë së veçantë. Nuk ka dyshim se disa shtete tashmë janë duke investuar masivisht në aftësitë kompjuterike që mund të shfrytëzohen për qëllime ushtarake. Në shikim të parë, gara e shifruar e armatimit është e bazuar në logjikë të qartë dhe të pashmangshme, pasi lufta kompjutewwwa epërsitë janë fillimisht në anën e sulmuesit. Për më tepër, pothuajse nuk ka asnjë parandalues të përshtatshëm për luftën kompjuterike, sepse edhe njëjtësimi i sulmuesit është jashtëzakonisht i vështirë dhe, në mbështetje të së drejtës ndërkombëtare, ndoshta gati i pamundur. Në këto rrethana, çdo formë e shpagimit ushtarak do të ishte tejet e ndërlikuar, si në pikëpamje ligjore, ashtu dhe politike. Aftësitë e mbrojtjes kompjuterike janë në zhvillim e sipër dhe pjesa më e madhe e shteteve perëndimore i kanë përmirësuar ndjeshëm mbrojtjet e tyre në vitet e fundit. Nga ana tjetër, megjithatë, aftësitë e mbrojtjes kompjuterike janë në zhvillim e sipër dhe pjesa më e madhe e shteteve perëndimore i kanë përmirësuar ndjeshëm mbrojtjet e tyre në vitet e fundit. Një mbrojtje e mirë kompjuterike i bën këto kërcënime të kontrollueshme, në atë masë që rreziqet mbetëse të mundshme duken përgjithësisht të pranueshme, të ngjashme me kërcënimet klasike. Por në vend që të flitet për luftën kompjuterike si një luftë në vetvete – duke i portretizuar goditjet e para të shifruara si një "Pearl Harbour i Shifruar" ose "11 Shtator i botës së kompjuterave" – do të ishte shumë më e përshtatshme për të përshkruar sulmet kompjuterike si një ndër mjetet e shumta të luftës. Sulmet kompjuterike përbëjnë një rrezik të vërtetë dhe përherë në rritje. Në të njëjtën kohë, nuk ka arsye për panik, sepse për të ardhmen e afërt këto kërcënime nuk do të jenë as të fundbotshme, as krejtësisht të pakontrollueshme.

Përballimi i Sfidës

NATO-s është duke u përshtatur për këtë lloj të ri sfide të sigurisë. Pothuajse një vit pas 11 Shtatorit, NATO bëri një thirrje të rëndësishme për të përmirësuar "aftësitë e veta mbrojtëse kundër sulmeve kompjuterike", si pjesë e zotimit për aftësitë në Pragë, të miratuar në nëntor 2002. Por në vitet vijuese pas 2002-it, Aleanca u përqendrua kryesisht në zbatimin e masave mbrojtëse pasive të kërkuara nga ana ushtarake. Vetëm ngjarjet në Estoni në pranverën e vitit 2007 e nxitën Aleancën të mendonte sërish në mënyrë rrënjësore për nevojën e një politike të mbrojtjes kompjuterike dhe për t'i dhënë shtysë kundërmasave të saj drejt një niveli të ri. Si rrjedhojë, Aleanca hartoi për herë të parë një dokument zyrtar "Politika e NATO-s për Mbrojtjen Kompjuterike", i miratuar në janar 2008, që hodhi bazat e krijimit të tri shtyllave themelore të politikës së hapësirës kompjuterike të Aleancës. 1)Mëvetësi pushteti vendor, d.m.th. ndihma jepet vetëm me kërkesë, në të kundërtën, gjen zbatim parimi i përgjegjësisë së vetë shteteve të pavarura. 2)Mosdyfishim, d.m.th. shmangie e dyfishimit të hallkave të panevojshme të strukturave apo të aftësive – në nivel ndërkombëtar, rajonal dhe kombëtar. 3) Siguri, d.m.th. bashkëpunim i mbështetur në mirëbesim, duke pasur parasysh ndjeshmërinë e informacionit të sistemit përkatës dhe cenueshmëritë e mundshme.Ky përbënte një hap cilësor përpara. Ai gjithashtu i hapi rrugën vendimeve kryesore të marra në Lisbonë për të shqyrtuar në vijimësi mbrojtjen kompjuterike si një çështje të pavarur në rendin e ditës të NATO-s. Duke marrë shkas nga ngjarje, si ajo e Kosovës më 1999 dhe e Estonisë më 2007 dhe e ndikuar thellë nga ndryshimet tronditëse në perceptimin e kërcënimit ndërkombëtar që prej shtatorit 2001, NATO kishte hedhur themelet për ndërtimin e një "Mbrojtjeje Kompjuterike 1.0". Ajo kishte zhvilluar mekanizmat dhe aftësitë e saj të para të mbrojtjes kompjuterike dhe kishte hartuar një Politikë fillestare të Mbrojtjes Kompjuterike. Me vendimet e Lisbonës në nëntor 2010, Aleanca më pas përgatiti me sukses truallin për një shqyrtim të vetëdrejtuar dhe të bazuar në fakte të çështjes. Duke vepruar në këtë mënyrë, NATO jo vetëm që është duke kryer një ripërtëritje aq shumë të nevojshme të strukturave, si Aftësia Kundërvepruese e NATO-s ndaj Incidenteve Kompjuterike, por gjithashtu, e bashkuar si një aleancë, po përgatitet për të përballuar sfidat mjaft të dallueshme dhe në rritje ndaj mbrojtjes kompjuterike. Në përshtatje me Konceptin e ri Strategjik të NATO-s, Politika e rishikuar e NATO-s mbi Mbrojtjen Kompjuterike i përcakton kërcënimet kompjuterike si një burim të mundshëm për mbrojtjen e përbashkët, në përputhje me nenin 5 të NATO-s. Për më tepër, politika e re dhe – Plani i Veprimit për zbatimin e saj – i mbështet shtetet e NATO-s me udhëzime të qarta dhe me një listë përparësish të miratuara mbi mënyrën e çuarjes përpara të mbrojtjes kompjuterike të Aleancës, përfshirë fuqizimin e bashkërendimit brenda NATO-s, si dhe me partnerët e saj. Kur vendimet e Lisbonës të jenë zbatuar plotësisht, Aleanca do të ketë ndërtuar një "Mbrojtje Kompjuterike 2.0" të përmirësuar. Duke vepruar në këtë mënyrë, Aleanca po dëshmon përsëri se mund ta kryejë këtë detyrë.

Burimi: Revista e Natos

West Point, krenari dhe pikë referimi

Akademia Shteteve të Bashkuara Ushtarake në West Point (USMA), e njohur edhe si West Point, Akademia Ushtarake, ose thjesht, The Point, është një akademi katërvjeçare e shërbimit federal e vendosur në West Point, Nju Jork. Akademia shtrihet në një pamje skenike të lartë me pamje nga Hudson River, 50 milje (80 km) në veri të New York City. I gjithë kampusi qendror është një pikë kombëtare referimi dhe për çdo amerikan për rezultatet e vendeve historike, ndërtesave, dhe monumenteve. Shumica e ndërtesave të kampusit janë ndërtuar prej graniti në ngjyrë gri dhe të zezë. Kampusi është një destinacion popullor turistik i plotë me një qendër të madhe të vizitorëve dhe muzeut të vjetër të Ushtrisë e Shteteve të Bashkuara. Kandidatët për pranim duhet të aplikojnë direkt në akademi dhe të marrin një nominim, zakonisht nga një anëtar i Kongresit. Burime të tjera të kandidimit përfshijnë Presidentin dhe zëvendës presidentin e Shteteve të Bashkuara. Studentët janë oficerë në trajnim dhe referohen si "kadetët" ose si "Kadetët e Korpusit të Shteteve të Bashkuara" (USCC). Shkollimi për kadetë financohet plotësisht nga ushtria në këmbim të një detyrimi të shërbimit aktiv në detyrë pas diplomimit. Rreth 1.300 kadetë hyjnë në Akademi çdo korrik, ku rreth 1.000 kadetë diplomohen. Programi akademik jep një diplomë Bachelor i Shkencave, me një program mësimor me një performancë të klasave të kadetëve "mbi një program të gjerë akademik, performanca e lidershipit ushtarak dhe pjesëmarrjen e detyrueshme konkuruese në atletikë. Kadetë janë të detyruar t'i përmbahen Kodit të Nderit të Kadetit. Akademia e bazon përvojën e një kadeti të lidershipit si një zhvillim të të tre shtyllave të performancës: akademikë, fizike dhe ushtarake.

Trupa e studentëve të West Pointit ka një strukturë unike në radhë dhe leksik. Të gjitha kadetët banojnë në kampus dhe të hanë së bashku. Kadetët konkurrojnë në një sport çdo vjeshtë, dimër, dhe sezon pranvere në intramural, klub, apo nivel ndëruniversitar. Ekipi i tij i futbollit ishte një fuqi kombëtare në fillim dhe në mes të shekullit të 20-të, duke fituar tre kampionate kombëtare. Në radhët e Akademisë përfshihen dy Presidentët e Shteteve të Bashkuara, (si dhe Presidentë të Shteteve aleate të Amerikës), presidentët e Kosta Rikas, Nikaraguas dhe Filipineve, gjeneralë të shumtë të famshëm.

Njoftim për studime ushtarake në SHBA

Qendra e Personel Rekrutimit (QPR) kërkon të rekrutojë studentë ushtarakë për studime në Akademitë Ushtarake në SHBA, 6 (gjashtë) vende për çdo akademi. Afati kohor për dorëzimin e dosjeve pranë QPR është deri në 31 tetor 2014.

Akademitë janë:
- Westpoint, Neë York, SH.B.A.
- Akademia e Forcave Ajrore, Colorado, SH.B.A.
- Akademia e Forcave Detare/Marinsave, Annapolis, Maryland, SH.B.A.

1. Kriteret e pranimit të kandidatëve:
- Të ketë shtetësi shqiptare.
- Të ketë kryer shkollë të mesme brenda ose jashtë vendit, të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë.
- Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë.
- Të jetë në moshë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 22 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik.
- Të mos jetë i martuar.
- Të jetë i aftë nga ana shëndetësore.
- Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen.
- Të mos jetë bartës i virusit HIV dhe Hepatit B; të mos ketë kaluar sëmundje të zemrës, veshkave, mëlçisë dhe mushkërive.
- Kandidatët që do të aplikojnë për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit të kenë notën mesatare të gjitha viteve të shkollës së mesme jo më pak se 8.5 si dhe të kenë notën mesatare jo më pak se 8.5 veças për lëndët, matematikë, fizikë, kimi.
- Të zotëroj gjuhën angleze në të lexuar, të shkruar dhe të folur, në bazë të testimit AL-CPT mbi 70 pikë, të zhvilluar nga Qendra e Gjuhëve të Huaja në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes.
- Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit në rast se:

a) Zotërojnë diplomë ushtarake për nivelin arsimor për të cilin aplikojnë;
b) Kanë fituar më parë statusin e studentit ushtarak;
c) Kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk kane përfunduar studimet.

- Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më sipër, s'kualifikohet.
- Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (Akademia e Forcave të Armatosura), në zbatim të pikës 2.12 të verë në dispozicion të QPR-së të dhënat që administrojnë për kandidatët subjekt të pikave a, b dhe c.

2. Dokumentet për regjistrim:
Kandidati për regjistrim duhet të paraqesë pranë Zyrës së Rekrutimit Tiranë këto dokumente:
- Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve ushtarake në SHBA, ku të specifikohet akademia për të cilën aplikohet dhe/ose të renditen akademitë që preferohen nga kandidati.
- Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, ANEKSI A.
- Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar që vërteton përfundimin e shkollës së mesme dhe listës së notave.
- Certifikatë për TOEFL, SAT ose ACT (nëse e ka).
- Dokument i cili vërteton se aplikanti është regjistruar për testimet që zhvillohen online TOEFL, SAT ose ACT. Data e zhvillimit të testimit nuk duhet të jetë më vonë se javën e dytë të muajit nëntor.
- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Certifikatë familjare 1 (një) copë.
- Fotografi për dokument, 2 (dy) copë.
- Dëshmi penaliteti.
- Vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor.
- Vërtetim nga prokuroria që nuk është në proces hetimi.
- Vërtetim nga përmbarimi.
- Raport mjekësor nga Spitali Ushtarak i Forcës Tokësore ku shprehet nëse kandidati është i aftë për të ndjekur studimet ushtarake jashtë vendit.
- Analiza e SIDA-s.
- Vërtetimet mjekësore se kandidati nuk është bartës i virusit HIV dhe Hepatit "B" dhe që nuk ka kaluar sëmundje të zemrës, veshkave, mëlçisë dhe mushkërive.
- Fotokopje e pasaportës së vlefshme për jashtë shtetit.

3. Datat e testimit:
Testi Psikologjik: 05.11.2014
Testi Fizik: 07.11.2014 (të dhënat e testimit fizik)
Testi i Gjuhës së Huaj: 11.11.2014
Testi Intelektual: 13.11.2014

Stoltenberg, pasues i Rasmussenit

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, u largua zyrtarisht pas përfundimit së mandatit të tij pas pesë vjetësh e dy muajsh në krye të Aleancës më 30 shtator 2014, si Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s. Ai u emërua si Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s nga udhëheqësit e Aleancës në samitin e Strasburg-Kehl, në vitin 2009, kur ai ishte kreu i Qeverisë së Danimarkës. Rasmussen e mori detyrën më 1 gusht të vitit 2009.

Jens Stoltenberg mori postin e tij si Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s më 1 tetor 2014. Ish kryeministri norvegjez u emërua nga 28 aleatët në muajin mars, për të pasuar Rasmussen si Sekretar i Përgjithshëm. Ai ka qenë më parë kryeministër i Norvegjisë nga vitet 2000-2001 dhe nga vitet 2005-2013.